

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5871
E premte, 6 shtator 2019
çmimi 0.40 €

Nicholas Abbott:
Do ta mbështes luftën
kundër korrupsionit
dhe nepotizmit **FAQE 7**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

FLET PËR "EPOKËN E RE", QËNDRON KASTRATI **FAQE 4-5**

Koalicioni AAK - PSD ka gjasa të fitojë



Nënkryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Qëndron Kastrati, ka vlerësuar se AAK - PSD është një prej koalicioneve më komplementare që është bërë në Kosovë. Ai ka thënë se bashkimi i këtyre dy subjekteve politike për

zgjedhjet e 6 tetorit është kombinim shumë i qëlluar. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kastrati ka thënë se koalicioni AAK - PSD ka potencial të madh për zhvillim shoqëror dhe për proceset e

ardhshme në vend. Ai ka shprehur optimizëm se ky koalicion do të dalë fitues në zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Madje, sipas Kastratit, PSD-ja dhe AAK-ja do të kenë rritje më shumë se 100 për qind



AVOKATI I POPULLIT:
TË RESPEKTOHET PARIMI
I BARAZISË GJINORE NË
PROCESIN ZGJEDHOR **F. 5**

**HARADINAJ: PËRFAQËSUESIT
POLITIKË TË JENË UNIKË NË
ZGJEDHJET E 8 SHTATORIT NË
MEDVEGJË F. 6**



EKONOMI



**KODI +383, I PAQASSHËM PËR
VERIFIKIMIN E DYFISHTË TË
APLIKACIONEVE F. 8**

**PËR TRE MUAJ MBI 86 MIJË
PERSONA VIZITUAN HOTELET
E KOSOVËS F. 9**

SPORT

**BERISHA DHE HASANI: LUAJMË
PËR FITORE NDAJ ÇEKISË F. 14**



Partitë të përmbahen nga fjalori fyes dhe premtimet pa mbulesë

Shoqëria civile dhe njohësit e rrethanave politike i kanë ftuar të gjitha subjektet politike që do të marrin pjesë në zgjedhjet e 6 tetorit, që të tregohen të matur me fjalorin që përdorin dhe me premtimet që japin gjatë fushatës zgjedhore. Ata kanë bërë me dije se fjalori fyes dhe premtimet e porealizueshme e bastardojnë fushatën. Sipas tyre, lidhshipi i partive politike duhet të ndër marrë masa ndaj kandidatëve që nuk tregohen të disiplinuar **FAQE 3**

Dy të vrarë dhe dy të plagosur në Prishtinë



Policia e Kosovës ka konfirmuar se dy persona kanë vdekur dhe dy të tjerë janë plagosur të enjten në Prishtinë si pasojë e të shtënave me armë zjarri. Zyrtarët policorë kanë treguar se tashmë kanë arrestuar dy persona lidhur me këtë rast **FAQE 3**

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Bushati i përgjigjet Ballës: Shkodra e di kush e kandidoi Valdrinin

TIRANË, 5 SHTATOR - Ish-ministri i Jashtëm shqiptar dhe anëtari i Kryesisë së Partisë Socialiste, Ditmir Bushati, flet për nevojën e një "kordonit sanitar" apo filtrave të rreptë për të parandaluar kandidimin e personave me të kaluar të dyshimtë.

Në një intervistë për 'Zërin e Amerikës', ai shprehet se

"integriteti i jetës publike duhet mbrojtur me çdo kusht dhe refuzimin për ta parë një gjë të tillë, do të mund të quhej pa ngurrim, një katastrofë shtetërore".

I pyetur për deklaratimet e bëra më pas nga sekretari i përgjithshëm socialist Taulant Balla, sipas të cilit kandidatura e Valdrin Pjetrit në Shkodër

ishite propozuar nga ish-ministri i Jashtëm, Bushati deklaroi se "Shkodra e di kush e kandidoi Valdrin Pjetrin. Asambleja e Partisë Socialiste propozoi 3 kandidatë të tjerë", u shpreh ai. Bushati kërkoi gjithashtu kompromis me opozitën jashtëparlamentare pasi, siç tha ai, vendi ndodhet përpara sfidave të rëndësishme.



Cakaj: Vlerësime pozitive nga vendet e BE-së për çeljen e negociatave

Ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj, tha se ne kemi një konfirmim paraprak politik të Komisionit dhe Shqipëria qëndron në avantazh dhe me shpresa për hapjen e negociatave me BE-në, e që është një proces që nuk varet vetëm nga Shqipëria, por edhe nga zhvillimet e tjera në Evropë

TIRANË, 5 SHTATOR - "Shqipëria qëndron në avantazh dhe me mundësi serioze për hapjen e negociatave në tetor", deklaroi të enjten ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj, gjatë një interpelance me ekspertë të fushës së integritetit dhe studentë.

Pak kohë nga vendimi i rëndësishëm për hapjen e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian, Cakaj iu përgjigj grupeve të interesit mbi arritjet konkrete në pesë prioritetet kyçe, ngritjen e strukturave shtetërore për procesin screening dhe pritshmëritë për një vendim pozitiv nga KE-ja në tetor.

Duke folur për arritjet dhe sfidat e këtij procesi, Cakaj tha se "konkluzionet e Këshillit të qershorit 2019, bëjnë të qartë se të gjitha vendet anëtare në mënyrë pozitive vlerësojnë raportin e Komisionit në veçanti dhe rekomandimin për hapje të pa kushtëzuar të negociatave me Shqipërinë".

"Prioritetet kyçe kanë të bëjnë

me vazhdimin dhe thellimin e rezultateve në procesin e vetingut, ngritjen e trupave të reja gjyqësore sipas reformës në drejtësi dhe thellimin e rezultateve në luftën kundër krimit dhe korrupsionit. Artikulli 54 i konkluzioneve të Këshillit thotë se Komisioni Evropian duhet të jetë veçanërisht i fokusuar në shqyrtimin nëse këto kushte janë përmbushur nga Shqipëria apo jo. Dhe KE-ja e ka dhënë përgjigjen me vlerësimin e reformës të paprecedent të Shqipërisë në drejtësi", tha Cakaj.

Edhe lidhur me ngritjen e trupave të reja gjyqësore, sipas tij, "janë krijuar kushtet për vazhdimin më tej drejt krijimit të SPAK dhe Byrosë Zyrtare të Hetimeve". Sipas KE-së, tha Cakaj, gjithçka po zhvillohet brenda kornizave kohore të përcaktuara nga reforma në drejtësi. "KE-ja konstaton se Shqipëria ka arritur në shkallën më të lartë të luftës ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit. Janë konfiskuar asete kriminale dhe janë goditur



celula të krimit", tha ai.

Cakaj shtoi se "mbi këto rezultate që nuk janë perceptim i Qeverisë shqiptare por gjetje objektive të KE-së, Shqipëria ka rastin që mbi meritat e saj të çelë negociatat". "Ne kemi një konfirmim paraprak politik të Komisionit. Shqipëria qëndron në avantazh dhe me shpresa për hapjen e negociatave me BE-në. Ky është një proces që nuk varet vetëm

nga Shqipëria, por edhe nga zhvillimet e tjera në Evropë. Ne jemi duke punuar jo vetëm për të hapur negociatat, por për të qenë në pozicionin e duhur edhe pasi të hapen negociatat. Ne nuk mund të operojmë mbi situata me pikëpyetje, por ne jemi të angazhuar për hapjen e negociatave në tetor. Angazhimi ynë politik do të mundësojë një shndërrim cilësor të vlerësimit

teknik pozitiv të KE-së, në një vullnet pozitiv të Këshillit, që Shqipëria atë që ka pasur aspiratë në vite, nga tatori ta shndërrojë në realitet", tha Cakaj.

Cakaj tha se puna është përqendruar që Shqipëria të sigurojë jo vetëm shkallën më të lartë të ekspertizës, por edhe të mos përsërisë disa prej gabimeve të vendeve të tjera". "Struktura negociatore ka dy shtylla, njëra ka të bëjë me anën operacionale dhe mbikëqyrëse për përmbushjen e kushteve specifike dhe në anën tjetër shtylla operative apo funksionale që bën kryerjen konkrete të detyrave teknike gjatë këtij procesi", tha ai.

Cakaj foli edhe për rolin që do të marrin institucionet dhe strukturat e ndryshme të administratës, pas çeljes së negociatave, si dhe përfshirjen e shoqërisë civile në këtë proces. Ai tha se kapacitetet e Shqipërisë deri tani janë përqendruar në procesin screening, duke u përshtatur gjatë procesit. "Jemi besimplotë dhe nuk kemi asnjë dyshim se Shqipëria gëzon të gjitha kapacitetet e nevojshme për çeljen e negociatave. Në rastin kur të hapen negociatat, Shqipëria do të jetë në pozicionin që nuk ka humbur kohë dhe ka kryer pjesën teknike. Kjo do të jetë dëshmi shtesë që Shqipëria gëzon kapacitetin institucional dhe organizativ për të zhvilluar një proces efektiv të negociimit", tha Cakaj.

Një delegacion i Kongresit amerikan viziton Malin e Zi

PODGORICË, 5 SHTATOR - Senatori amerikan Lindsey Graham tha në Podgoricë se Shtetet e Bashkuara janë mik dhe partner i Malit të Zi. "Kongresi është aleati juaj, dhe shpresojmë që në vitin 2020 t'i dëshmoni vetes dhe botës se demokracia mbetet në Mal të Zi përgjithmonë", tha senatori republikan, i cili vizitoi Malin e Zi në krye të një delegacioni të

Kongresit amerikan. Delegacioni përgëzoi Malin e Zi për reformat në shoqërinë malazeze dhe shprehu gatishmërinë e Kongresit për të ndihmuar në forcimin e rolit të Malit të Zi në rajon. Kryeministri i Malit të Zi, Dushko Markoviq, në takim me senatorin Graham falënderoi Uashingtonin për mbështetjen e vazhdueshme.

"Pa mbështetjen e ShBA-së, tha ai, Mali i Zi nuk do të ishte aty ku është sot. Ai tha se Mali i Zi vlerëson bashkëpunimin dhe ndihmën në forcimin e shtetit ligjor dhe të institucioneve. Delegacioni u prit në takime të ndara edhe nga kryetari i Parlamentit të Malit të Zi, Ivan Brajoviq dhe nga presidenti malazias, Milo Gjukanoviq.



Kërkohet që subjekte politike të bëjnë fushatë korrekte

Partitë të përmbahen nga fjalori fyes dhe premtimet pa mbulesë

Shoqëria civile dhe njohësit e rrethanave politike i kanë ftuar subjektet politike që do të marrin pjesë në zgjedhjet e 6 tetorit, që të tregohen të matura me fjalorin që përdorin dhe me premtimet që japin gjatë fushatës zgjedhore. Ata kanë bërë me dije se fjalori fyes dhe premtimet e porealizueshme e bastardojnë fushatën. Sipas tyre, lidhshipi i partive politike duhet të ndërmarë masa ndaj kandidatëve që nuk tregohen të disiplinuar



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Shoqëria civile, njohësit e rrethanave politike dhe disa liderë politikë kanë kërkuar nga partitë politike të jenë të kujdesshme me fjalorin që përdorin dhe me premtimet që japin gjatë fushatës zgjedhore. Ata kanë bërë thirrje se në aktivitetet e tyre parazgjedhore partitë politike duhet të heqin dorë nga fjalori i urrëjtjes dhe nga premtimet pa mbulesë.

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) nëpërmjet një reagoni për medie ka bërë me dije se kryetarët e partive politike duhet të sigurojnë publikisht se anëtarët e partive të tyre t'i përmbahen një rregulli dhe discipline gjatë fushatës. "KMDLNj thërret të gjitha subjektet politike që do të marrin pjesë në zgjedhjet e jashtëzakonshme, që

të kenë kujdes se çfarë fjalori përdorin, duke e eliminuar fjalorin e urrëjtjes si mjet dhe mundësi për mbledhje të votave. Kryetarët e partive politike duhet të sigurojnë publikisht se anëtarët e partisë si dhe garuesit për deputetë të Kuvendit do t'i përmbahen një rregulli dhe discipline, në të kundërtën ndaj atyre që nuk i respektojnë rregullat e lojës garuese të ndershme duhet të ndërmarin masa", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Ky këshill ka vlerësuar se partitë duhet të jenë modeste edhe në premtimet e tyre elektorale. "Partitë garuese duhet të jenë modeste në dhënien e premtimeve dhe këmbëngulëse në realizimin e atyre premtimeve që duhet të jenë reale dhe objektive. Premtimet e mëdha dhe fjalët e mëdha e kanë humbur seriozitetin e fushatave të mëparshme, prandaj KMDLNj shpreson se këto parti kanë

nxjerrë mësim nga e kaluara dhe se nuk do t'i përsërisin premtimet e njëjta, aq më parë që ka ndryshuar si konteksti politik ashtu edhe ai ekonomik", ka vlerësuar këshilli.

Edhe analisti politik Belul Beqaj i ka ftuar kandidatët për kryeministër që të jenë të kujdesshëm në premtimet e tyre para dhe gjatë fushatës zgjedhore. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se premtimet joreale të subjekteve politike e bastardojnë fushatën. "Prenmtimet joreale e bastardojnë fushatën dhe ato parti dhe ata individë që japin premtime pa mbulesa. Prandaj, kandidatët për kryeministër dhe deputetët duhet të përmbahen nga manipulimet dhe lajthitjet. Ata mund të mashtrojnë gjatë fushatës votuesit, por do ta humbin besimin pas zgjedhjeve.

Subjektet mashtrojnë një herë, dy herë, por besoj se nuk munden vazhdimisht", ka thënë Beqaj.

Për garë korrekte subjektet politike i ka ftuar edhe kryetari i LDK-së, Isa Mustafa. Ai ka kërkuar nga kundërshtarët politikë që mos të përdorin metoda të ulëta kundër kandidatës për kryeministër, Vjosa Osmani. "Ka filluar keq. Mos veproni me mjete të ulëta, e mos u shërbeni me gënjeshtër e montime kundër znj. Vjosa Osmani, kandidatë për kryeministër nga LDK-ja. Nëse keni kurajë, garoni me mjete demokratike, mos shpenzoni para për ekspertë e prodhues të gënjeshtërave nga vendet e tjera. Gara jonë duhet të jetë garë fer, demokratike, e argumentuar dhe jo fushatë e militantëve që shpërndajnë

akuza e gënjeshtër të rrezikshme për kandidaten tonë dhe të dëmshme për vendin", ka shkruar Mustafa në profilin e vet në "Facebook".

Ditë më parë edhe kandidati për kryeministër i koalicionit Nisma-AKR-PD, Fatmir Limaj, ka thënë se forcat politike në Kosovë duhet të jenë të kujdesshme dhe të mos e humbin racionalitetin para njerëzve duke premtuar gjëra që nuk arrihen. "Duhet jemi të kujdesshëm çka po premtojmë. Sepse mbi bazën e premtimeve qytetarët e Kosovës po i ngritin pritjet dhe tani, në pamundësi për t'i realizuar ato premtime, po zhgënjehen", ka thënë Limaj. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur që fushata për zgjedhjet e 6 tetorit të jetë dhjetë ditë. Ajo do të fillojë më 25 shtator dhe do të përfundojë më 4 tetor.

Korab Sejdiu nuk do të kandidojë për deputet

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Korab Sejdiu, nuk do të kandidojë për deputet në zgjedhjet e 6 tetorit. Ai ka bërë me dije se ka pasur oferta nga LDK-ja dhe LV-ja për të qenë pjesë e listës së tyre për deputet, por për arsye personale ka vendosur të mos kandidojë. "Duhet theksuar se jam tepër mirënjohës për ofertat e jashtëzakonshme të bashkëpunimit që më kanë ofruar LDK-ja dhe LV-ja, të cilat tregojnë për qëllimin e këtyre dy partive (që do të doja të kishin garuar bashkë) që qeveria e ardhshme të ketë njerëz të vullnetit të mirë që kanë synim të vetëm një Kosovë të përparuar dhe jetë të mirë për qytetarët e saj. Pavarësisht nga kjo, kryesisht për arsye të natyrës personale/familjare, unë kam marrë vendimin jo të lehtë, që të

mos kandidoj edhe për një mandat si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës", ka shkruar Sejdiu në profilin e vet në "Facebook".

Megjithatë, ai i ka ftuar qytetarët e Kosovës që të dalin në zgjedhjet e 6 tetorit. "Ndiej një dozë rehatie me këtë vendim jo të lehtë, duke kuptuar se mosprania në Kuvend nuk më kufizon në asnjë mënyrë që të vazhdoj me përkushtim më të lartë për të kontribuar për përmirësimin e jetës së qytetarëve në vend dhe për t'i luftuar dukuritë negative të shoqërisë sonë. Dhe në këtë moment, kontributin më të madh fillestar që ne të gjithë mund ta japim është që të dalim masivisht në zgjedhjet e 6 tetorit, pasi këtë herë, si kurrë më parë, kemi mundësi të zgjedhim në mes të dy kandidatëve për kryeministër që janë të jashtëza-



konshëm", ka shkruar Sejdiu. Sejdiu në legjislaturën e gjashtë ishte zgjedhur deputet i AKR-së, por pasi kjo parti kishte hyrë në

koalicion qeverisës me PAN-n, ai ishte larguar nga ky subjekt politik për të vepruar deputet i pavarur. Ditë më parë edhe ish-deputeti i

Alternativës, Ilir Dedaj, ka treguar se nuk do të kandidojë për deputet në zgjedhjet e 6 tetorit.

Flet për "Epokën e re", Qëndron Kastrati

Koalicioni AAK - PSD

Nënkryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Qëndron Kastrati, ka vlerësuar se AAK - PSD është një prej koalicioneve më komplementare që është bërë në Kosovë. Ai ka thënë se bashkimi i këtyre dy subjekteve politike për zgjedhjet e 6 tetorit është kombinim shumë i qëlluar. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kastrati ka thënë se koalicioni AAK - PSD ka potencial të madh për zhvillim shoqëror dhe për proceset e ardhshme në vend. Ai ka shprehur optimizëm se ky koalicion do të jetë fitues i zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Madje, sipas Kastratit, PSD-ja dhe AAK-ja do të kenë rritje më shumë se 100 për qind

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Nënkryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD) dhe kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka thënë se kjo parti nuk do ta kishte problem kalimin e pragut zgjedhor. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai e ka quajtur banale të mendohet se PSD-ja nuk ka garuar e vetme në zgjedhjet e 6 tetorit meqë ka pasur frikë se nuk mund ta kalojë pragun zgjedhor. "Në Kosovë do të jenë rreth 750 mijë votues. Për ta kaluar pragun duhen rreth 38 mijë vota. Nëse e përkthejmë në aspektin e komunave që jemi duke dëshmuar qeverisje transparente, luftim të korrupsionit, përfshirje të qytetarëve në vendimmarrje, si dhe duke pasur parasysh edhe 12 deputetët shumë aktivë që janë marrë konkretisht me tema konkrete e që kanë të bëjnë me mirëqenien e qytetarëve, është banale të mendohet se PSD-ja nuk ka mundësi ta kalojë pragun zgjedhor", ka deklaruar Kastrati.

Ai ka thënë se për rrethanat në të cilat ndodhet Kosova, arritja e koalicionit AAK-PSD ka qenë e domosdoshme. "Duke pasur parasysh proceset që pritet të ndodhin në Kosovë dhe nevojën e bashkimit për t'u ballafaquar me këto procese, mendoj se ka qenë zgjidhje e domosdoshme. Ne duhet ta kuptojmë se koalicionet bëhen në raport me rrethanat që i kemi. Edhe në raport me negociatat me Serbinë është e domosdoshme të kombinohen guximi, dija, përgatitja dhe përvoja që Kosova të përfaqësohet në gjendjen më të mirë dhe ta

arrijë marrëveshjen", është shprehur Kastrati. Ai ka thënë se koalicioni AAK-PSD ka potencial të madh për zhvillim shoqëror dhe për proceset e ardhshme në vend. Kastrati ka shprehur optimizëm se ky koalicion do të dalë fitues në zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Madje, sipas tij, PSD-ja dhe AAK-ja do të kenë rritje më shumë se 100 për qind.

"Epoka e re": Z. Kastrati, Partia Socialdemokrate (PSD) vendosi që në zgjedhjet e 6 tetorit të mos garojë e vetme, por në koalicion me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Si erdhi ky vendim? Patët frikë se nuk do të mund ta kaloni pragun zgjedhor?

Kastrati: Jo, nuk qëndron kjo që jeni duke e thënë. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, se vetëm koalicioni apo partia që del e para në zgjedhje e ka mandatarin dhe mundësinë për ta formuar qeverinë, i ka nxitur subjektet politike për të bërë koalicione parazgjedhore. Janë dy arsye pse e kemi bërë një marrëveshje të tillë. E para që të bëhemi bashkë me dikë që ka potencial të dalë subjekti i parë në zgjedhje, e dyta janë proceset që e presin Kosovën. Nuk është interesim i vogël gatishmëria e fuqive ndërkombe të përfundohet çështja në mes të Kosovës dhe Serbisë. ShBA-ja ka emëruar një përfaqësues special për Ballkanin, po ashtu pritet edhe BE-ja ta bëjë këtë si dhe ambasadori rus, që është caktuar në Serbi, është një prej figurave më të fuqishme dhe me ndikim aty. Në një situatë të tillë ne si shoqëri dhe si Kosovë duhet të përkujdesemi që mos t'i kemi përfaqësues në dialog ata të cilët nuk e kanë guximin



për të thënë jo edhe për diçka që është e dëmshme për Kosovën. Bazuar në këtë dhe prej përvojës 20-vjeçare, është vetëm Ramush Haradinaj që ka dëshmuar se është i gatshëm të thotë jo nëse diçka është në dëm të Kosovës. Këto janë dy arsyet pse jemi bërë bashkë në një koalicion me potencial për t'i fituar zgjedhjet dhe për të qenë prej subjekteve të ardhshme në qeverisje të cilat

do të jenë të përfshira në një marrëveshje potenciale që është historike dhe do të ndikojë për 50 vjetët e ardhshëm për qytetarët në Kosovë dhe për gjithë Ballkanin.

"Epoka e re": Pra, për PSD-në nuk ka qenë problematike çështja e pragut, siç po thonë ish-bashkëpartiakët tuaj?

Kastrati: Në Kosovë do të jenë rreth 750 mijë votues. Për ta

kaluar pragun duhen rreth 38 mijë vota. Nëse e përkthejmë në aspektin e komunave që jemi duke dëshmuar qeverisje transparente, luftim të korrupsionit, përfshirje të qytetarëve në vendimmarrje, si dhe duke pasur parasysh edhe 12 deputetët shumë aktivë që janë marrë konkretisht me tema konkrete e që kanë të bëjnë me mirëqenien e qytetarëve, është banale të mendohet se PSD-ja

ka gjasa të fitojë

dije, e dikush tjetër ka diçka tjetër dhe kur ato bëhen bashkë krijojnë një trup i cili është me potencial të madh edhe për zhvillim shoqëror, por edhe për proceset e ardhshme në vend.

"Epoka e re": Nuk mendoni se PSD-ja mund të humbë vota për shkak të këtij koalicioni?

Kastrati: Duke pasur parasysh proceset që pritet të ndodhin në Kosovë dhe nevojën e bashkimit për t'u ballafaquar me këto procese, mendoj se ka qenë një zgjidhje e domosdoshme. Ne duhet ta kuptojmë se koalicionet bëhen në raport me rrethanat që i kemi. Në raport me negociatat me Serbinë është e domosdoshme të kombinohen guximi, dija, përgatitja dhe përvoja që Kosova të përfaqësohet në gjendjen më të mirë dhe ta arrijë marrëveshjen. Unë po e shoh që shumica e subjekteve politike po përpiqen t'i shmangin proceset e ardhshme që e presin Kosovën sepse janë të vetëdijshme se këto procese nuk shkojnë në favor që ato individualisht ose grupisht mund ta përfaqësojnë dhe ta mbrojnë Kosovën më së miri.

"Epoka e re": Në këto zgjedhje janë tri parti të mëdha dhe një koalicion që pretendojnë vendin e parë. Si e shihni këtë garë? Kush është pretendenti kryesor?

Kastrati: Meqenëse nuk mund ta shmangim marrëveshjen me Serbinë, por duhet të merremi me të si dhe duke pasur parasysh projektet zhvillimore në shërbim të mirëqenies qytetare, mendoj se koalicioni AAK-PSD i ka gjasat e mëdha të fitojë.

"Epoka e re": Bazuar në pritjet tuaja për fitore, po i bie që do të ketë rritje 100 për qind.

Kastrati: Nëse i keni përcjellë sondazhet dhe anketat prej kompanive profesionale, rritja do të jetë më shumë se 100 për qind.

"Epoka e re": Sa për qind apo sa deputetë pretendoni t'i merrni si koalicion dhe si PSD?

Kastrati: Për ne janë të rëndësishme proceset e ardhshme. Nuk do të ketë garë të brendshme qoftë brenda subjekteve, qoftë brenda kandidatëve. Potenciali ynë është që të dalë koalicioni i pari.

"Epoka e re": Ju do të jeni pjesë e listës për deputet?

Kastrati: Është çështje që ende

s'e kemi vendosur, por për mua me rëndësi kanë projektet që e presin Kosovën. Por, në koordinim me subjektin dhe koalicionin vendimin do ta marrim në kohën e duhur.

"Epoka e re": A do t'ju penalizojë në votë reforma e nisur në arsim në Kamenicë?

Kastrati: Reforma në arsim në lokacione të caktuara mund të ndikojë në vota por, në përgjithësi në Kosovë, do të jetë shumë pozitive edhe për shkak të testit PISA, edhe për shkak të gjendjes në arsim. Shumica e qytetarëve që mendojnë dhe e

kanë një vizion se si do të zhvillohet ky vend mendojnë se reformat në arsim janë më të rëndësishmet edhe për kohën e tashme, edhe për të ardhmen e kësaj shoqërie.

"Epoka e re": Meqë po synoni fitore më 6 tetor, kënd e shihni partner për bashkëqeverisje, meqë deri më tani asnjë prej partive nuk ka mundur t'i fitojë mbi 50 për qind të votave?

Kastrati: Mendoj se është e mirë për demokracinë që mos të ketë subjekte që veç vetë i marrin mbi 50 për qind. Për ne është e qartë se PDK-ja është

vijë e kuqe shkak i së kaluarës së saj. Ç'kapja e shtetit, luftimi i korrupsionit dhe reforma në drejtësi e administratë nuk mund të bëhen me PDK-në. Është e domosdoshme që për një ose dy mandate kjo parti të mbetet në opozitë. Në anën tjetër, nuk po them se ne nuk duam, por për shkak të së kaluarës së saj dhe për shkak se ka dëshmuar jokonstruktivitet në procese dhe në marrëdhënie me të tjerët, edhe Lëvizja Vetëvendosje e ka pothuajse të pamundur të jetë në qeverinë e ardhshme.

Avokati i Popullit: Të respektohet parimi i barazisë gjinore në procesin zgjedhor

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Avokati i Popullit nëpërmjet një deklarate ka kërkuar prej partive politike respektimin e parimit të barazisë gjinore në procesin zgjedhor të 6 tetorit. Ky institucion pret që partitë politike të bëjnë përfaqësim të barabartë në listat zgjedhore në pajtim me dispozitat e Ligjit për Barazi Gjinore. "Avokati i Popullit pret nga subjektet politike që të marrin pjesë në këtë proces zgjedhor ashtu siç pret edhe nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) që ta respektojë parimin e barazisë në tërë procesin zgjedhor, me theks të veçantë përfaqësimin e barabartë në listat zgjedhore në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore dhe pajtueshmërinë me frymën të cilën e përcjell Kushtetuta e Republikës së Kosovës", është thënë në deklaratën e këtij institucioni.

Më tutje, është theksuar se garantimi i mundësive të barabarta dhe pa diskriminim mbi baza gjinore jo vetëm është i domosdoshëm për një shoqëri demokratike, por është përcaktim kushtetues dhe ligjor që duhet të zbatohet nga të gjithë, përfshirë këtu edhe partitë politike. "Të zgjedhësh dhe të jesh i zgjedhur është e drejtë e garantuar për secilin shtetas të Republikës së Kosovës mbi

moshën 18 vjeç. Në këtë kuptim, duke pasur parasysh zgjedhjet paraprahe, Avokati i Popullit rikthen vëmendjen e publikut të gjerë dhe të autoriteteve kompetente për mundësitë e barabarta për pjesëmarrje të të dyja gjinive, në të gjitha segmentet e procesit zgjedhor, duke e konsideruar, ashtu sikurse edhe Kushtetuta e vendit, barazinë gjinore vlerë themelore për zhvillim demokratik të shoqërisë", është thënë në deklaratë.

Avokati i Popullit ua rikujton subjekteve politike se Ligji për Barazi Gjinore, respektivisht

neni 14 i tij, shprehimisht thotë se 'partitë politike me aktet e tyre obligohen t'i zbatojnë masat për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të meshkujve dhe femrave në organet dhe trupat e partive në pajtim me dispozitat e nenit 6 të këtij ligji'. "Avokati i Popullit e konsideron veprim të detyrueshëm dhënien e mundësive të barabarta pa diskriminim mbi çfarëdo baze në listat e kandidatëve dhe në procesin zgjedhor si tërësi dhe bën thirrje publike që kjo të sigurohet", është theksuar në vazhdimin e deklaratës së Avokatit të Popullit.



nuk ka mundësi ta kalojë pragun zgjedhor.

"Epoka e re": Si po funksionon në terren ky koalicion dhe cilat janë pritjet tuaja?

Kastrati: Është një prej koalicioneve më komplementare që ka ndodhur në Kosovë. Domethënë, e plotësojnë njëra-tjetrën. Është kombinim shumë i qëlluar. Dikush ka kapacitete, potencial, guxim,

Dy të vrarë dhe dy të plagosur në Prishtinë

Policia e Kosovës ka konfirmuar se dy persona kanë vdekur dhe dy të tjerë janë plagosur të enjten në Prishtinë si pasojë e të shtënave me armë zjarri. Zyrtarët policorë kanë treguar se tashmë kanë arrestuar dy persona lidhur me këtë rast

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Dy persona kanë vdekur dhe dy të tjerë janë plagosur të enjten në Prishtinë si pasojë e të shtënave me armë zjarri, ka konfirmuar Policia e Kosovës. Qendra Klinike Universitare e Kosovës ka konfirmuar vdekjen e dy prej të plagosurve. "Katër

persona janë sjellë në Emergjencë. Pavarësisht prej kujdesit maksimal nga stafi mjekësor, dy prej të plagosurve kanë vdekur, pasi nuk kanë arritur t'u shpëtojnë plagëve, kurse dy të tjerët janë duke u ekzaminuar nga stafi mjekësor i Klinikës Emergjente", ka



thënë Shpend Fazliu, zëdhënës në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Kurse në njoftimin e policisë është thënë se ngjarja ka ndodhur në rrugën "Muharrem Fejza" në Prishtinë, ku policia ka pranuar informata se ka të shtëna me armë zjarri. "Menjëherë në vendin e ngjar-

jes kanë dalë njësitet policore, të cilat kanë hasur në katër persona të plagosur. Të njëjtit janë dërguar për tretman mjekësor", është thënë në njoftimin e Policisë.

Zyrtarët e Policisë së Kosovës kanë konfirmuar për mediet se tashmë kanë arrestuar dy persona lidhur me rastin dhe kanë

konfiskuar dy armë zjarri, një me tytë të shkurtër dhe një me tytë të gjatë. Sipas policisë, në incident dyshohet se janë përfshirë dy familje, të cilat pretendohet se banojnë në të njëjtën ndërtesë.

Zyrtarët e Policisë së Kosovës kanë thënë se hetimet për këtë rast janë duke vazhduar.



Haradinaj: Përfaqësuesit politikë të jenë unikë në zgjedhjet e 8 shtatorit në Medvegjë



PRISHTINË, 5 SHTATOR - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të enjten në takim përfaqësuesit e partive politike nga Medvegja, përfaqësuesit e Alternativës për Ndryshim, të Partisë Demokratike dhe atë të Partisë për Veprim Demokratik, me të cilët ka biseduar për situatën dhe zhvillimet aktuale në rajon. Kryeministri Haradinaj ka shprehur angazhimin dhe mbështetjen për komunitetin shqiptar në këtë

komunë për t'i realizuar të drejtat e veta dhe për ta siguruar mbijetesën në këto treva. Duke vlerësuar situatën aktuale, Komuna e Medvegjës do t'i mbajë zgjedhjet për autoritete komunale këtë të diel dhe në takim është theksuar nevoja që komuniteti shqiptar duhet të jetë unik dhe duhet të gjejë forma dhe rrugë të bashkëveprimit dhe përfaqësimit adekuat në këto organe. "U pajtuam që të gjithë shqiptarët me të drejtë vote në këtë komunë duhet ta kryejnë

obligimin qytetar dhe t'i votojnë kandidatët më të mirë", ka thënë kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj. Ai ka deklaruar se si qeveri në dorëheqje do t'i adresojë me kujdes shqetësimet e tyre për faktin se shteti serb po e vazhdon diskriminimin e shqiptarëve të këtij rajoni duke i fshirë nga lista e votuesve si dhe nga adresat legale në vendbanimet e tyre me qëllim të mohimit të së drejtës së votës dhe pamundësimin të përfaqësimit të tyre në nivel komunal.

Tahiri thotë se MD-ja është shembull për punësimin e bursistëve 'Young Cell Scheme'

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, të enjten ka pritur në takim bursistët e Programit "Young Cell Scheme", që kanë filluar punën në këtë ministri në fillim të këtij muaji.

"Angazhimi i bursistëve 'Young Cell Scheme' nuk është vetëm plotësim i një marrëveshje partneriteti mes institucioneve tona dhe Bashkimit Evropian, por është shpërfaqje e vullnetit për të ndërtuar shembuj që i duhen shtetit dhe shoqërisë, se të rinjtë

tanë të shkolluar e me kompetencë do të kenë rol primar në shërbimet që institucionet tona u ofrojnë qytetarëve", ka thënë ministri Tahiri.

Ai ka bërë me dije se janë punësuar gjithsej shtatë bursistë në departamente të ndryshme, pesë prej të cilëve kanë nisur punën këtë vit. "Qasja e tillë është, mes të tjerash, mesazh për të rinjtë e Republikës së Kosovës, se edukimi dhe ndërtimi i kompetencave profesionale është arma e tyre e vetme, më e fuqishme dhe e


duhura për të ndërtuar një karrierë të qëndrueshme brenda institucioneve tona", është shprehur Tahiri, duke shtuar se bursistët do të ndihmojnë në konsolidimin e administratës publike. "Për më tepër, angazhimi i këtyre të rinjve është në funksion të konsolidimit të administratës publike me potenciale të reja që i duhen institucioneve, që i duhen vendit dhe që e kanë vendin në Kosovë për dallim nga emigrimi dhe 'ikja e trurit'", ka thënë ministri Tahiri.



Presidenti Hashim Thaçi ka pranuar kredencialet nga ambasadori i ri i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Nicholas Abbott

Nicholas Abbott: Do ta mbështes luftën kundër korrupsionit dhe nepotizmit

Ambasadori i Britanisë së Madhe, Nicholas Abbott, të enjten ka filluar misionin diplomatik në Kosovë, me ç'rast ka premtuar se do ta mbështesë luftën kundër korrupsionit dhe nepotizmit. Ai ka shprehur përkushtimin për ta vazhduar punën për reformimin dhe modernizimin e institucioneve të Kosovës. Abbott është zotuar për thellimin e miqësisë dhe bashkëpunimit në mes të Mbretërisë së Bashkuar dhe Kosovës



Presidenti Thaçi pranoi kredencialet nga ambasadori i ri i Norvegjisë në Kosovë

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pranuar të enjten kredencialet nga ambasadori i ri i Norvegjisë për Kosovë, Jens Erik Grondahl. Presidenti Thaçi ka shprehur mirënjohje për përkrahjen që Norvegjia

vazhdon t'i japë Kosovës. "Jemi mirënjohës për marrëdhëniet e shkëlqyera bilaterale, por edhe për përkrahjen që Norvegjia i jep Kosovës në të gjithë mekanizmat ndërkombëtarë", ka deklaruar presidenti Thaçi. Sipas Thaçit, Norvegjia ka qenë aktore në të

gjitha proceset e rëndësishme në të cilat ka kaluar Kosova dhe se pret që ajo do ta përkrahë vendin tonë edhe në përballjen me sfidat aktuale. Ambasadori Grondahl ka bërë me dije se do ta vazhdojë thellimin e bashkëpunimit në mes dy vendeve.



EPOKA E RE **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Ambasadori i ri i Britanisë së Madhe në Kosovë, Nicholas Abbott, të enjten ka prezantuar kredencialet te presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi. Me këtë rast ambasadori Abbott ka thënë se Mbretëria e Bashkuar dhe Kosova gëzojnë lidhje të thella miqësie dhe bashkëpunimi. Ai ka thënë se do ta vazhdojë punën e paraardhësve të vet për të ndihmuar në reformimin dhe modernizimin e institucioneve të Kosovës. "Jam i lumtur që kam prezantuar letrën time kredenciale te presidenti Thaçi. Mbretëria e Bashkuar dhe Kosova gëzojnë lidhje të thella miqësie dhe bashkëpunimi, të farkëtuara në kohët më të vështira. Mezi pres të zhvilloj dhe forcoj marrëdhëniet tona me popullin e Kosovës dhe ta vazhdoj punën e paraardhësve të mi për të ndihmuar në reformimin dhe modernizimin e institucioneve. Po ashtu, për t'i inkurajuar dhe mbështetur ata që janë brenda sistemit dhe të cilët po luftojnë korrupsionin dhe nepotizmin", ka deklaruar Abbott.

Ndërsa presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se Britania e Madhe është partnere strategjike e Kosovës dhe se liria e pavarësia e Kosovës është e lidhur me rolin aktiv të Britanisë së Madhe. Thaçi ka thënë se mbështetja e Britanisë së Madhe mbetet thelbësore edhe në sfidat që i ka përpara Kosova nga konsolidimi i plotë ndërkombëtar i shtetësisë së Kosovës e deri tek anëtarësimi në mekanizmat euroatlantikë. Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur në takim ambasadorin e ri të Britanisë së Madhe, Nicholas Abbott, të cilit i ka uruar suk-

sese në detyrën e re në vendin tonë. Veseli ka thënë se Kosova dhe Britania e Madhe kanë bashkëpunim strategjik jashtëzakonisht të mirë. "Sot e prita ambasadorin e ri të Britanisë së Madhe, Nicholas Abbott. Kosova dhe Britania e Madhe kanë bashkëpunim strategjik jashtëzakonisht të mirë. Pa mbështetjen e miqve tanë perëndimorë Kosova nuk do të mund të konsolidohej as në rrafshin e brendshëm dhe as në atë ndërkombëtar. Ne mbesim të përkushtuar që ta forcojmë sundimin e ligjit dhe ta luftojmë korrupsionin në shoqërinë tonë. Ambasador Abbott, mirë se erdhe në Kosovë!", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook". Edhe kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur në takim ambasadorin e ri britanik në Kosovë, Nicholas Abbott, të cilit i ka uruar mirëseardhje në pozitën e tij për një mandat disaveçar në vendin tonë. Haradinaj e ka njoftuar ambasadorin Abbott për progresin e Kosovës, të arritur deri më tani, për proceset që po kalon vendi si shkuarja në zgjedhje, nevojën e forcimit të institucioneve demokratike, rritjen e mirëqenies së qytetarëve, thellimin e reformave në vend dhe konsolidimin ndërkombëtar të Kosovës.

Ai e ka falënderuar diplomatin Abbott për mbështetjen e vazhdueshme që Britania i ka dhënë dhe vazhdon t'i japë Kosovës në shumë fusha në të gjitha etapat e shtetndërtimit të saj dhe ka kërkuar nga ai mbështetjen e mëtejme për proceset nëpër të cilat po kalon Kosova. "Ndihma dhe angazhimi i Britanisë së Madhe është i nevojshëm për Kosovën dhe ky partneritet duhet të avancohet edhe në fusha të tjera, në interes për të dy vendet", ka thënë kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj.

Limaj: Fuqizimi i bujqve është prioritet kryesor i Nismës Socialdemokrate

PRISHTINË, 5 SHTATOR (ER) - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se prioritet kryesor i kësaj partie do të jenë investimet në bujqësi. "Të nderuar qytetarë të Kosovës, Nisma Socialdemokrate një nga prioritetet kryesore do ta ketë investimin në bujqësi. Fuqizimi i bujqve tanë nënkupton hapje të vendeve të reja të punës, zhvillim më të hovshëm ekonomik dhe siguri më të madhe të produkteve që konsumojmë. Në këta dy vjet qeverisjeje jemi munduar maksimi-

malisht t'i mbështesim prodhuesit vendorë, bizneset e vogla dhe të mesme, por kemi qenë të pakënaqur me politikat në bujqësi, për ç'gjë kam shprehur hapur pakënaqësinë time", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka bërë me dije se Nisma Socialdemokrate bashkë me partnerët e saj është duke hartuar programin qeverisës, ku një nga prioritetet kryesore do të jetë fuqizimi i bujqve të Kosovës. "Ne vlerësojmë se duhet ndryshuar formën e ndarjes së granteve në bujqësi, sepse kështu siç është

aplikuar deri më tani, nuk po ndihmohen sa duhet bujqit tanë. Nisma Socialdemokrate vlerëson se investimet në bujqësi përmes granteve duhen rritur ndjeshëm si parakusht për rritjen e sektorit të bujqësisë. Ne vlerësojmë se buxheti i Kosovës duhet të orientohet në investimet në bujqësi dhe në këtë drejtim planifikojmë të investojmë mbi 500 milionë euro në bujqësi (brenda një mandati katërvjeçar) duke stimuluar kështu bujqit tanë të kultivojnë kultura tradicionale dhe të reja bujqësore", ka shkruar Limaj.



Kosova shfuqizon vendimin për taksën ndaj Maqedonisë së Veriut



PRISHTINË, 5 SHTATOR (ER) - Pas vendimit të Maqedonisë së Veriut për eliminimin e ndalesës së eksportit të peshkut nga Kosova, ministri në detyrë i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Endrit Shala, ka bërë me dije se ka shfuqizuar vendimin e 16 gushit për taksën kundër Maqedonisë së Veriut. Shala nëpërmjet llogarisë së vet

në "Facebook" ka thënë se vetëm të bashkuar mund ta fitojnë respektin nga të gjithë. "Vetëm kur bëhemi bashkë për shtetin tonë mund ta arrijmë qëllimin, mund ta arrijmë respektin e të gjithëve. Pas reflektimit të Maqedonisë së Veriut, edhe unë sot kam marr vendim ta suspendoj vendimin për masa reci-

proke të para disa javëve në lidhje me produktet e Maqedonisë së Veriut që hyjnë në Kosovë. Ne do të vazhdojmë t'i mbrojmë prodhimet kosovare. Vetëm duke rritur prodhimin dhe duke rritur eksportin mund ta zhvillojmë shtetin. Prandaj, duhet të jemi bashkë për shtetin!", ka shkruar Shala.

Shpërndahen 70 kontrata për përfituesit e granteve 'Start-Up 2019'



PRISHTINË, 5 SHTATOR (ER) - Mbi 70 kontrata janë shpërndarë për përfituesit e skemës së granteve "Start-Up 2019", projekte këto të cilat financohen nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Ministri në detyrë i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Myzafer

Shala, ka thënë se përfituesit e këtij projekti mund të jenë liderë në të ardhmen. "Rinia që ne e kemi, pra në disa matje që kemi bërë që nga klasa e parë e deri në të 12-n, kemi mbi 330 mijë të rinj. Kjo rini është orientuar nga programet digjitale. Ne kemi bërë

edhe disa gjëra ku për këtë skemë kemi ndarë mbi 70 kontrata dhe me këtë këta përfitues mund të jenë liderë në të ardhmen. Ne jemi në kontakt me përfaqësues gjermanë që të sjellin kompani në Kosovë në mënyrë që të hapen vende të reja të punës. Kemi edhe

parkun e ndërmarrësisë në Prizren ku synojmë që ky park në të ardhmen të zgjerohet edhe më shumë", ka thënë Shala. Ndërsa prorektorja e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Myrvete Badivuku, ka falënderuar Ministrinë e Inovacionit për

këtë përkrahje, derisa ka thënë se kjo mënyre e kësaj ministrie është në favor të ndaljes së emigrimit të të rinjve nga Kosova. Ndërsa prorektori i UP-së, Faton Berisha, ka thënë se Universiteti i Prishtinës ka nevojë për afrimin e të rinjve në vendimmarrje.

Dogana: Marrëveshja Kosovë - Turqi do të krijojë një zonë të tregtisë së lirë

PRISHTINË, 5 SHTATOR (ER) - Dogana e Kosovës ka vlerësuar se marrëveshja e tregtisë së lirë në mes të Kosovës dhe Turqisë konfirmon synimin e palëve të jenë pjesë aktive në procesin e

integritimit ekonomik evropian, duke shprehur gatishmërinë e bashkëpunimit për gjetjen e mënyrave dhe mjeteve për të forcuar këtë proces. "Gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje

Turqia dhe Kosova do të krijojnë gradualisht një zonë dypalëshe të tregtisë së lirë, ku lëvizja e lirë e mallrave dhe shërbimeve janë të garantuara reciprokisht. Shërbimet do të

jenë subjekt i negocimit menjëherë pas hyrjes në zbatim të kësaj marrëveshje", është thënë në njoftimin e Doganës së Kosovës.



Kodi +383, i paqasshëm për verifikimin e dyfishtë të aplikacioneve

Përdoruesit e telefonisë mobile dhe të pajisjeve tjera të komunikimit në Kosovë janë duke hasur probleme gjatë përdorimit të aplikacioneve të ndryshme për shkak të kodit të ri telefonik +383. Kryetari i Bordit të ARKEP-it, Kreshnik Gashi, ka thënë se këto probleme kanë ardhur pas kalimit të kodeve të huaja ndërkombëtare në kodin shtetëror të Kosovës +383. Sipas tij, problemet në fjalë janë duke u shkaktuar edhe për shkak të mospërfshirjes së Kosovës në listën zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Organizatës së Kombeve të Bashkuara

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Verifikimi i dyfishtë është një procedurë që tashmë kërkohet nga shumë aplikacione të cilat kanë gjetur përdorim të shtuar sot në botë qoftë për një shfletim të postës elektronike (e-mail) apo edhe për aplikacionet e famshme të platformave si "Microsoft", "Google", "Viber", "WhatsApp", "Snapchat" etj. Ky lloj verifikimi kërkon që krahas fjalëkalimit, përdoruesit të përdorin edhe një kod i cili atyre u vjen përmes numrit të tyre personal të telefonit. Përderisa në disa prej këtyre platformave të mëdha, autoritetet e Kosovës kanë arritur ta përfshijnë kodin e ri, +383, problemet paraqiten me aplikacione me të vogla.

Qëndresa Ajeti, një kliente e operatorit të telefonisë mobile "Vala", ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se nuk ka arritur ta bëjë shkarkimin e disa aplikacioneve nga interneti për shkak të pamundësisë që ta pranojë kodin e nevojshëm në numrin e saj të telefonit. "Në shumë raste nuk kam arritur ta bëj shkarkimin e aplikacioneve të ndryshme për shkak se kodi i cili duhet të vijë në telefon nuk ka ardhur. Nuk e di se ku qëndron problemi", ka thënë ajo.

Një pjesë e madhe e këtyre problemeve, sipas kryetarit të Bordit

të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), Kreshnik Gashi, janë si pasojë e mospërfshirjes së Kosovës në listën zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Ai ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se këto probleme kanë ardhur pas kalimit të kodeve të huaja ndërkombëtare në kodin shtetëror të Kosovës +383. "Ka shumë aplikacione në botë që e përdorin verifikimin e dyfishtë si një nga opsionet për ta arritur sigurinë në mënyrë që të autoidentifikohet përdoruesi i llogarisë së caktuar. Ky problem është shfaqur në disa aplikacione me rastin e kalimit në kodin +383, për faktin se Kosova nuk është e listuar në Organizatën Ndërkombëtare të Standardizimit (ISO), standardin 3166, që merret me akronimet e shteteve, përkatësisht e merr listën e shteteve nga Agjencia e Statistikave të OKB-së, ku Kosova nuk është në këtë listë dhe nuk jemi të listuar në ISO, standardin përkatës. Prandaj ka probleme të kohëpaskohshme në disa aplikacione", ka thënë Gashi. Kosovës i është ndarë kodi telefonik nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikimeve (ITU) në dhjetor të vitit 2016. Ndërkohë,



largimi i kodeve të huaja të cilat ishin përdorur si ai i Monakos +377 dhe kodi i Sllovenisë +386 kanë filluar të largohen nga muaji shkurt i këtij viti. Gashi ka thënë se është detyrë teknike dhe obliguese e operatorëve të telefonisë në Kosovë, që gjatë kalimit në kodin +383 të njoftojnë sa më shumë operatorë të aplikacioneve të ndryshme, në mënyrë që qytetarët të mos kenë probleme në autoidentifikimin e dyfishtë. "Si ARKEP, me marrjen e kodit +383 i kemi kontaktuar në mënyrë direkte disa nga aplikacionet më të mëdha që përdoren në Kosovë, siç është platforma e 'Google', 'Viber', 'WhatsApp' në mënyrë që Kosova të jetë e listuar, por është detyrë teknike e operatorëve që të njoftojnë në vazhdimësi edhe aplikacionet më të vogla në mënyrë që të listohet edhe kodi +383. Përveç kësaj, duhet t'i njoftojnë edhe qytetarët se ka nevojë të ndryshohet edhe formati i numrit telefonik që përdoret për verifikim. Nëse e marrim platformën e 'Google', aty është

i vendosur kodi +383, por nëse (në telefon) nuk është ndërruar nga përdoruesi dhe ka mbetur kodi +386 apo +377, ka mundësi që nuk vjen mesazhi apo thirrja në drejtim të verifikimit", ka thënë Gashi. Ai ka theksuar se Kosova duhet që identitetin digjital ta ndërtojë duke lobuar tek aplikacionet e ndryshme, te platformat e ndryshme sepse nuk mund ta marrin automatikisht.

Ndërsa zëdhënësi i Telekomit të Kosovës, Arsim Bilalli, ka thënë se nuk janë në dijeni për raste të tilla të raportuara, por nëse konsumatorët që marrin shërbimet nga Telekomit kanë probleme të tilla, ai i fton ata që të kërkojnë ndihmë në Qendrën e Thirrjeve dhe shërbimin e konsumatorëve. Por, nuk janë vetëm problemet ndërkombëtare që po e përcjellin zbatimin e kodit +383 të Kosovës. Klientët të operatorit "Vala" ankohen vazhdimisht se nuk po arrijnë të pranojnë dhe të bëjnë thirrje. Me këtë rast, Bilalli përmes një përgjigjeje elektronike dërguar "Radios Evropa e

Lirë" nuk e përjashton mundësinë që të ketë vështirësi për realizimin e thirrjeve qoftë për shkak të ngarkesës së shtuar të trafikut apo mirëmbajtjes së planifikuar të rrjetit. Por, këto probleme, sipas tij, mund të jenë vetëm në zona të caktuara dhe në kohë të kufizuara.

Probleme teknike në sistemin operativ kishin ndodhur edhe në korrik të këtij viti. Problemet teknike në sistemin operativ të "Valës" në atë kohë kishin ardhur si pasojë e ngarkesës së madhe që ka pasur në rrjet por që, si të tilla, ishin eliminuar, patën thënë zyrtarë të Telekomit. Në atë kohë ekspertët të çështjeve të telekomunikimeve patën theksuar se kjo nuk do të duhej të ndodhte, pasi që rrezikon sigurinë nacionale. Driart Elshani, ekspert i çështjeve të telekomunikimeve, pati thënë për "Radion Evropa e Lirë" se është e rëndësishme që Kosova të ketë një rrjet të veçantë për shërbime emergjente që në rastet si këto, telekomunikimet për shërbime emergjente të jenë funksionale.

Për tre muaj mbi 86 mijë persona vizituan hotelet e Kosovës

PRISHTINË, 5 SHTATOR (ER) - Gjatë tremujorit të dytë të këtij viti hotelet e Kosovës janë vizituar nga 68 251 vizitorë, prej tyre 64.67 për qind kanë qenë të huaj. Kështu është thënë në raportin "Statistikat e hotelierisë, tremujori i dytë 2019", i cili është prezantuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Sipas kësaj agjencie, numri i netëve të qëndrimeve në këtë tremujor ishte 115 501 bujtje. "Në tremujorin e dytë të 2019-s, numri i vizitorëve (vëndorë dhe të huaj) është 68 251, prej tyre 35.33 për qind janë vëndorë dhe 64.67 për qind janë të huaj, ndërsa numri i netqëndrimeve

është 115 501, prej tyre 39.7 për qind nga vëndorët dhe 67.39 për qind nga të huajt", është thënë në raportin e ASK-së. Për sa i përket numrit të vizitorëve, rajoni i Prishtinës është në vëndin e parë, pasuar nga ai i Prizrenit. "Numrin më të madh të vizitorëve dhe netqëndrimeve të tyre e ka rajoni i Prishtinës me 27 563 vizitorë dhe 47 534 netqëndrimi. Numri më i madh i vizitorëve të huaj përqendrohet në Prishtinë, Prizren e kështu me radhë. Sa iu përket vizitorëve të huaj, numri më i madh ishte nga Shqipëria, Gjermania, Turqia etj." është thënë në raportin e ASK-së.



Më 12 shtator fillon projekti për vizita mjekësore në Skenderaj

SKENDERAJ, 5 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka pritur në takim përfaqësuesit e organizatës "Human Care", me seli në Prishtinë, ku ishte i pran-

ishëm edhe drejtori i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), Fazli Kadriu. Në takim është diskutuar për fillimin e projektit sa i përket bashkëpunimit në mes të Komunës së

Skenderajt dhe organizatës në fjalë rreth vizitave mjekësore specialiste në QKMF, QMF dhe nëpër shtëpi, për t'u ofruar shërbim rasteve sociale dhe atyre që nuk mund t'i vizitojnë qendrat

mjekësore. Ky projekt është bashkëfinansim në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe "Human Care", i cili do të fillojë nga data 12 shtator dhe do të vazhdojë dy muaj.



Hapet ekspozita 'ta njohim trashëgiminë kulturore përmes fotografive'

KAÇANIK, 5 SHTATOR (ER) - Në Shtëpinë e Kulturës "Xheladin Kurtaj" në Kaçanik është hapur ekspozita "Ta njohim trashëgiminë kulturore përmes fotografive", e cila është organizuar nga HANDIKOS, ndërsa është realizuar në kuadër të një projekti të financuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Në hapjen e kësaj ekspozite, Elmihane Krasniqi, drejtoreshë e HANDIKOS-it në Kaçanik, ka falënderuar të gjithë ata që mundësuan realizimin e kësaj ekspozite, duke bërë me dije se qëllimi kryesor i këtij projekti është socializimi i fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të veçanta si dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe promovimi i punës vullnetare përmes të rinjve të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal në Kaçanik. Të pranishëm në ekspozitë ishin edhe përfaqësues të institucioneve komunale, nënkryetari i Kaçanikut, Ylber Bajra, si dhe drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Diana Reka.



Në lagjen 'Dardania' në Prizren shpërndahen 300 kontejnerë për mbeturina



PRIZREN, 5 SHTATOR (ER) - Komuna e Prizrenit ka bërë me dije se në lagjen "Dardania" ka filluar shpërndarja e rreth 300 kontejnerëve për ndarjen e mbeturinave ricikluese në amvisëri, e cila po realizohet si zgjerim i projektit për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme në burim. Ky projekt, në kuadër të të cilit edhe në

lagjen "Ortakoll" ishin vendosur 300 kontejnerë të tillë, realizohet në bashkëpunim në mes të Sektorit të Menaxhimit të Mbeturinave në Komunën e Prizrenit, Zyrës Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) dhe organizatës "Green Art Center". "Komuna e Prizrenit fton qytetarët që ta mbështesin

këtë projekt, ku me hedhjen e mbeturinave ricikluese, siç janë shishet e plastikës dhe kanaqet, do të kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen e burimeve natyrore dhe reduktimin e ndotjes dhe sasisë së mbeturinave nëpër deponi", është thënë në njoftimin e Komunës së Prizrenit.

Përfundon projekti i rrjetit të kanalizimit në tre fshatra të Malishevës

MALISHEVË, 5 SHTATOR (ER) - Kanë përfunduar punimet për ndërtimin e dy kilometrave të rrjetit të ri të kanalizimit në fshatrat Panorç, Rud dhe Garaqevë të Komunës së Malishevës. Ky rrjet i kanalizimit është ndërtuar në kuadër të realizimit të projekteve kapitale për vitin 2019 dhe në kuadër të realizimit të planifikimeve komunale për këtë vit.

Përfundimin e projektit në fshatin Rud e ka parë nga afër edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, i cili ishte shoqëruar edhe nga mbikëqyrësi i projektit, Ahmet Morina. Gjatë inspektimit të punimeve ata janë takuar edhe me banorët, të cilët janë ndarë të kënaqur me zgjerimin e rrjetit të kanalizimit në këto fshatra. "Është bërë një punë e mirë dhe

është realizuar një kërkesë e banorëve të këtyre vendbanimeve, të cilët kishin nevojë që të zgjerohet rrjeti ekzistues i kanalizimit, në mënyrë që edhe shtëpitë e reja që janë ndërtuar, por edhe ato që për shkak të konfiguracionit të terrenit më herët nuk kanë pasur qasje në rrjetin e kanalizimit, tani të kenë qasje", ka thënë Berisha gjatë vizitës në Rud dhe Garaqevë.



Godina e Shkollës Teknike '28 Nëntori' në Prishtinë është objekt historik dhe duhet të mbrohet nga shteti



Shkruan: Sadri FETIU

Sot në Prishtinë u mbajt një proteste e nxënësve dhe e arsimtarëve të Gjimnazit "Ahmet Gashi" për shkak se kjo shkollë ishte mbyllur për ta nga organet kompetente komunale, me pretekst se godina ishte e vjetruar dhe nuk i plotësonte kushtet normale për punë... Në vend të kësaj godine, që do të rrënohej siç kishin vendosur këto organe, hapësira do të përdorej për destinime të tjera... Në të vërtetë godina në fjalë ishte e Shkollës së Mesme Teknike "19 Nëntori" në fillim, e pastaj "28 Nëntori", e cila, me vendimin e këtyre organeve, ishte liruar për t'i bërë vend gjimnazit që do të pagëzohej me emrin e një atdhetari nga periudha e Luftës së Dytë Botërore,

profesorit të gjeografisë, Ahmet Gashit...

Hapësirës (truallit) ku gjendet objekti në fjalë kaheerë ia kishte "vënë syrin" mafia e sotme e keqpërdoruesve dhe e shfrytëzuesve të pamëshirshëm të pasurisë sonë publike. Prandaj këtu nuk mundi të zë vend as Gjimnazi "Ahmet Gashi"...

Veprimet e këtyre ditëve flasin qartë se me çfarë perfiditeti kishin vepruar organet komunale të Prishtinës për ta zhdukur një objekt me vlera të veçanta mu nga qendra historike e Prishtinës. Pra, ishte e qartë taktika: së pari zhvendose nga trualli, shlyeja emrin e historinë e pastaj rrënoje me themel edhe godinën...

Duhet të thuhet se drejtuesit matrapazë të Shkollës Teknike "28 Nëntori", pa bërë asnjë kundërshtim, për interesat e tyre meskine kishin pranuar që shkolla të zhvendosej nga objekti e vet, që i plotësonte të gjitha kushtet për punë dhe të shpërngulej diku në periferi të qytetit...

Pushtetarët zhgërryes e kishin

maskuar bukur qëllimin e tyre me emrin e atdhetarit Ahmet Gashi dhe pritnin momentin kur do ta privatizonin (të themi më qartë: ta plaçkitnin në tërësi truallin mu "në zemër të qytetit" për ndërtime të banesave ose të objekteve të tjera, nga përfitimet e të cilave do të ngopej grykësia e tyre e shfrenuar...)

Nuk është fare me rëndësi se kush janë ata që po orvaten ta keqpërdorin, do ta zhgërryjnë (zhvatën) këtë pasuri publike... Dihet mirë një gjë: ata nuk kanë kurrfarë konsiderate për vlerën historike që ka godina e Shkollës Teknike "28 Nëntori" në Prishtinë e as për kurrfarë vlere tjetër kombëtare të popullit tonë...

Se ndërtesa e Shkollës Teknike "19 Nëntori", përkatësisht "28 Nëntori", ka vlerë historike, mund të thuhet edhe për arsyen e thjeshtë se ajo godinë gjendet mu në pjesën e vjetër historike të Prishtinës, të cilën ne si popull i qytetëruar dhe si shtet i organizuar jemi të detyruar që ta ruajmë...

Në këtë ndërtesë janë shkolluar

pothuajse të gjitha kuadrat teknike të Kosovës, profesorët e fakulteteve teknike (makineri, ndërtimtari, elektro), inxhinierët e shumtë - ata që e kanë bartur barrën e zhvillimit të eltroekonomisë, të termocentraleve, të Fabrikës së Amortizatorëve, të minierave tona e të ndërmarrjeve të ndryshme ndërtimore e prodhuese...

Shkolla Teknike "28 Nëntori" e ka edhe historinë e vet të aktiviteteve atdhetare. Nxënësit dhe arsimtarët e kësaj shkolle qëndruan të pathyeshëm pothuajse një gjysmë shekulli në tortura dhe në burgjet jugosllave...

Nuk është nevoja që të përmenden me emra të veçantë, sepse është përgjithësisht e ditur se nxënësit e kësaj shkolle janë organizatorë të demonstratave të vitit 1968. Ata u përgjakën, u burgosën e torturuan dhe u fljuan në këto demonstrata, madje edhe ranë dëshmorë, si më 1968, po ashtu edhe më 1981 e më vonë deri në Luftën Çlirimtare të UÇK-së...

Në qoftë se popujt e qytetëruar

gëzohen kur e gjejnë edhe një gjysmëshkrimi në gjuhën e tyre dhe i ruajnë me kujdesin maksimal objektet ku janë gjetur ato, ne a thua jemi aq primitivë sa mos të jemi në gjendje ta çmojmë vlerën e një objekti që flet shumë për arsimimin e inteligjencies sonë teknike dhe që është dëshmi për kalitjen e një brezi revolucionarësh që i organizuan demonstratat e viteve 1968, 1981 dhe Luftën Çlirimtare të UÇK-së...

Duke përfunduar këtë shkrim të shkurtër i ftoj të gjithë njerëzit vullnetmirë që ta ngrehin zërin kundër obskurantizmit të pushtetarëve tanë, që kanë vendosur ta shkatërrojë objektin historik të Shkollës së Mesme Teknike "28 Nëntori" në Prishtinë. Mendoj se ky objekt në gjendjen çfarë është sot me pak investime mund të përdoret edhe shumë vjet për nevoja të arsimit dhe se duhet të ruhet si vlerë e veçantë e pjesës së vjetër historike të Prishtinës, të cilën, fatkeqësisht, po e shkatërrojmë për ditë e më shumë...

Ahmeti: Gjimnazi 'Ahmet Gashi', në gjendje të rëndë infrastrukturore



PRISHTINË, 5 SHTATOR (ER) - Kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, është takuar të enjten me përfaqësuesit e nxënësve, mësimitdhënësve dhe drejtorin e Gjimnazit "Ahmet Gashi", me të cilët ka biseduar rreth zhvillimeve në këtë shkollë, konkretisht rreth vendimit për mbylljen e kësaj shkolle. Ahmeti

ka thënë se kjo shkollë vazhdon të jetë në gjendje të rëndë infrastrukturore. "Kemi dërguar ekspertët për ta përgatitur projektin e renovimit të shkollës, por në raport na është thënë se shkolla paraqet rrezik për nxënësit për shkak të dëmtimit në shtyllat mbajtëse dhe themelet e shkollës. Ne kemi ven-

dosur që përkohësisht t'i zhvendosim nxënësit, sepse me jetë nuk bëjmë kompromise. Bashkë me Këshillin Drejtues të shkollës jemi marrë vesh edhe për një vlerësim profesional, për të na dhënë mendim të dytë për gjendjen e shkollës. Në bazë të raporteve vendosim se a po e rinovojmë,

apo nevojitet rindërtim. Në secilin rast lëvizja e nxënësve është e përkohshme për shkak të sigurisë së tyre. Po e shoh se një subjekt politik po tenton ta politizojë rastin duke shpërndarë propagandë të rrejshme, por duhet ta dinë që me jetë të fëmijëve nuk ka politikë dhe nuk ka kompromis",

ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

Takimi i Ahmetit me përfaqësuesit e nxënësve, mësimitdhënësve dhe drejtorin e Gjimnazit "Ahmet Gashi" ka ndodhur pas protestës që këta të fundit e kanë mbajtur në lidhje me mbylljen e kësaj shkolle.

E rrallë

"Mercedes"-i më i vjetër në Evropë gjendet në Drenas

Është prodhuar para më shumë se 60 vjetësh. Bëhet fjalë për veturën e tipit "Mercedes", makinë e cila është ndër seritë e para të kësaj marke. Kjo makinë është blerë nga një qytetar i Drenasit, i cili, pas modifikimit, e ka kthyer atë në një automjet luksi.



BARSOLETA E DITËS



Burri: Grua, ku ma ke lënë librin "Si të jetojë 100 vjet"?
Gruaja: E kam djegur.
Burri: Pse?
Gruaja: Sepse ia nisi ta lexonte nëna jote.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 15:30 The Angry Birds Movie 2 (3D)

Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 39 min
 Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj, etj.

Regjia: Thurop Van Orman



FOTO E DITES



Përkrahësit pro Bashkimit Evropian protestojnë para ndërtesës së Parlamentit në Londër. /AP/

Në ora 17:30

GOOD BOYS

Aventurë/Komedi; 1 orë 29 min

Rolet: Jacob Tremblay, Keith L. Williams, Brady Noon, Molly Gordon, Lil Rel Howery, Will Forte, etj.

Regjia: Gene Stupnitsky




Çdo ditë në ora 19:15

"HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.
 Regjia: David Leitch



E jashtëzakonshme

Vegjetarianët janë shumë më të rrezikuar nga tromboza

Vegjetarianët janë shumë më të rrezikuar nga një trombozë e mundshme sesa ngrënësit e mishit. Shkencëtarët e Universitetit të Oxfordit, të cilët kanë vëzhguar për 18 vjet 50 000

njerëz, besojnë se shkak është mungesa e vitaminave të marra nga mishit. Kështu është vënë re se moskonsumimi i tij çonte në 20 për qind më shumë prekshmëri nga goditja cerebrale e cila

ndodh në momentin kur gjaku i një arterieje nis të rrjedhë në tru. Studiuesit janë shprehur se përgjegjës për të gjithë këtë është niveli i ulët i disa vitaminave kryesore, përfshirë B12-n.



Çdo natë në ora 21:30 ONCE UPON A TIME IN HOLLYWOOD

Komedi/Dramë; 2 orë 41 min

Rolet: Leonardo DiCaprio, Brad Pitt, Margot Robbie, Al Pacino, etj.

Regjia: Quentin Tarantino

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: **Kino ABC**.

 <p>DASHI Një ditë shumë e bukur mbushur me ngjarje të reja. Do të keni një miksim të pasionit dhe xhentileses me partnerin.</p>	 <p>DEMI Hëna në shenjë nuk ju bën shumë miq të mirë sot. Megjithatë do të neutralizoni gjithçka gjatë pasdites në një ambient familjar.</p>	 <p>BINJAKËT Një ditë shumë me fat sa iu përket financave. Do të merrni lajme të mira kudo ku keni pasur ide për investime ose punë të reja.</p>	 <p>GAFORRJA Do t'ju duken më të lehta problemet e ditës falë pranisë së Hënës në shenjën tuaj. Me kursimet do të jeni shumë i kënaqur sot.</p>	 <p>LUANI Megjithëse sot ndiheni në qendër të vëmendjes, mos mendoni se bota rrotullohet rreth jush.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Ditë e qetë kjo e sotmja dhe ju po ndiheni mjaft mirë me këtë qetësi. Në fund të fundit, pak pushim nuk mund t'ju bëjë veçse mirë.</p>
 <p>PESHORJA Me optimizmin dhe dashurinë tuaj arrini të përçoni mjaft energji pozitive të të tjerët. Dita sot paraqitet e këndshme.</p>	 <p>AKREPI Një ditë shumë e lodhshme si nga aktivitetet dhe nga njerëzit që ju rrethojnë. Do t'ju duhet të përballeni vetë me pjesën më të madhe të gjërave.</p>	 <p>SHIGJETARI Me tre planetë në shenjën tuaj sot, bëhuni gati ta fitoni lotarinë. Është një ditë mjaft e favorshme për çdo investim.</p>	 <p>BRICJAPI Sot jeni të pakënaqur me disa situata që sapo i keni vënë re. Do të shkoni të ankoheni tek miku juaj më i mirë.</p>	 <p>UJORI Do të pëlqeni vende ku lëvrohet kultura dhe arti sot. Jeni shumë të dashuruar me kulinarinë e mirë dhe do ta kënaqni shpirtin dhe stomakun.</p>	 <p>PESHQIT Sot i gjithë fokusi juaj është i përqendruar te puna. Keni lënë pak pas dore partnerin, por do të rikuperoni në darkë.</p>



Nusja e Milot Rashicës sjell imazhet me të gjitha veshjet në kanagjeq

Futbollisti i Kombëtares së Kosovës, Milot Rashica, po i jep fund beqarisë këtë muaj. E fejuara e Rashicës, Belkiz Kera, ditët e fundit ishte pjesë e medieve rozë mjaft shumë, për faktin se e fejuara e Milotit e bëri kanagjeqin, nga i cili publikoi pamje të shumta. E kur jemi te pamjet, disa imazhe të reja nga kanagjegji i saj, i organizuar në muajin gusht, Belkizi, ka publikuar së fundmi në llogarinë e vet në "Instagram", ku shihet në secilën



veshje që ajo ka zgjedhur të veshë. Ajo është dukur si një nuse tipike shqiptare, me dimi e jelek dhe me dutane si të princeshave. Çifti është i fejuar në vitin 2015.

Thirrje për aplikim.

Kompania Dhemetra Joint Venture ne Gjilan, kërkon një ofertues / kontraktor apo kompani te interesuar dhe te kualifikuar qe te dorëzojë një oferte/propozim për zhvillimin strategjik dhe te marketingut për produktet tona.

Kompania e interesuar duhet te kontaktoj direkt

Dhemetra JV nëpërmjet e-mail : info@dhemetrajv.com

apo telefonit: 045 121 499.

Nora Istrefi mund ta bëjë Robertin të "pendohet" me këto foto

E dhe pse ka vetëm pak kohë që kur është konfirmuar ndarja në mes të Robert Berishës dhe Nora Istrefit, kjo e fundit duket se e ka marrë veten. Për momentin, ajo është duke shijuar pushimet bashkë me vajzën e saj të vogël, Renenë. Nora ka shumë ndjekës në rrjetet sociale dhe nuk heziton aspak që t'ua shuajë kureshtjen se çfarë bën dhe ku ndodhet. Së fundmi, Istrefi ka postuar disa foto në llogarinë e vet në "Instagram" ku shihet tejet e "kurrar". Me bikini të kuqe dhe me flokë të lëshuara ajo na tregon se është më në formë se kurrë.



Vdes legjenda e fotove bardh e zi, Peter Lindbergh



Fotografi i modës Peter Lindbergh, i njohur për fotot bardh e zi, ka vdekur në moshën 74-vjeçare. I lindur më 1944 në Lindbergh, ai ka punuar me shumë stilistë të mëdhenj dhe revista ndërkombëtare gjatë karrierës së tij. Së fundmi, ai ka punuar me Meghan Markle, Dukeshën e Sussex, për botimin e shtatorit të revistës "Vogue". Në vitet 1990 Lindbergh ishte i njohur për fotografimin e modeleve si Naomi

Campbell dhe Cindy Crawford. Lindbergh kishte studiuar në Akademinë e Arteve të Bukura në Berlin në vitet 1960. Ai kishte ndihmuar fotografimin gjerman Hans Lux për dy vjet para se ta hapte studion e tij në 1973. Më pas ishte transferuar në Paris në 1978 për ta vazhduar karrierën e tij. Puna e Lindberghut si fotograf ishte shfaqur në revista të tilla si: "Vogue", "Vanity Fair", "Harper's Bazaar" dhe "New Yorker".

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com




QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Berisha dhe Hasani: Luajmë për fitore ndaj Çekisë

Përfaqësuesja e Kosovës ka zhvilluar stërvitjen e parafundit në stadiumin "Fadil Vokrri", kurse futbollistët Bernard Berisha dhe Florent Hasani kanë shprehur optimizëm se të shtunën tri pikët do t'u takojnë "dardanëve", ani pse Çekia ka një kombëtare shumë të fortë. Përgatitjen e fundit Kosova e zhvillon sot (e premte) nga ora 15:00



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e ka zhvilluar të enjten në mesditë stërvitjen e radhës para ndeshjes me Republikën e Çekisë e cila është e vlefshme për kualifikimet në Kampionatin Evropian. Në këtë seancë stërvitore atmosfera në kampin e "dardanëve" ishte e mirë dhe se të pranishëm ishin të gjithë futbollistët e ftuar nga përzgjedhësi Bernard Challandes. Mesfushori Bernard Berisha është rikthyer në përfaqësuese, kurse është shprehur i habitur se pse ende nuk i është dhënë mundësia në asnjë ndeshje zyrtare. "Është kënaqësi gjithmonë të jem këtu. Jam ftuar sepse kam zhvilluar një kampionat shumë të mirë. Trajneri dhe të gjithë e dinë se jam në një

moment shumë të mirë dhe kam dëshirë ta jap më të mirën për klubin dhe për Kosovën, por nuk e di pse nuk më është dhënë mundësia në asnjë ndeshje zyrtare. E kam pritur këtë moment. Trajneri e di që jam këtu për të luajtur dhe shpresoj se do ta ndihmoj Kosovën", ka thënë Berisha, i cili e ka pranuar se Çekia është favorite, por se "dardanët" do të luajnë për fitore. "Kemi shumë mungesa, por duke marrë parasysh se këtu ka shumë talentë, secili dëshiron ta tregojë vlerën që ka. Çekia është favorite, por ne do të mundohemi ta arrijmë fitoren sepse nuk kemi tjetër zgjidhje. Me fitore synojmë t'i gëzojmë gjithë shqiptarët nëpër botë", ka shtuar Berisha. Për ndeshjen e së shtunës që zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" nga ora 15:00 foli edhe futbollisti Florent Hasani. Edhe ky i fundit është optimist

se Kosova mund t'i marrë pikët e plota në këtë ndeshje. "Kemi kualitet që ta mposhtim Çekinë, edhe pse dihet se është një kombëtare me përvojë, por me ekipin që kemi besoj se mund t'i marrim tri pikë. Mendoj se ndeshjet me Çekinë brenda dhe jashtë do të jenë vendimtare për Kosovën", ka deklaruar Hasani. Ndërsa Florent Hadërgjonaj ka shkuar edhe më larg, duke thënë se është në gjendje të luajë në cilindo pozicion që ia kërkon trajneri Challandes. "Kam luajtur edhe në Gjermani dhe Angli si i majtë, megjithëse preferoj të luaj në krahun e djathtë. Mirëpo, nëse trajneri ma kërkon një gjë të tillë, nuk është problem. Jam i gatshëm ta ndihmoj ekipin", ka thënë Hadërgjonaj. Kosova renditet në pozitën e tretë me 5 pikë, kurse Çekia është e dyta me 6 pikë.

SHKURT

Southgate: Kosova nuk njuh humbje prej shumë kohësh

Kombëtarja e Anglisë do të përballet me Përfaqësuesen e Kosovës më 10 shtator. Trajneri i "Tre Luanëve", Gareth Southgate, i ka vlerësuar "dardanët" si të fortë, që nuk kanë pësuar humbje që një kohë të gjatë. "Mendoj se duhet të jemi me këmbë në tokë për ndeshjet e radhës. Kosova është një shembull i mrekullueshëm në futboll. Njerëzit nuk e njohin shumë, por nuk njuh një humbje prej shumë kohësh. Është një shtet i ri dhe ka futbollistë cilësorë", ka thënë Southgate.

Xhaka mohon mosmarrëveshjet me Shaqirin

Granit Xhaka ka hedhur poshtë thashethemet e medieve zvicerane se bashkatdhetari i tij, Xherdan Shaqiri, e ka braktisur Zvicrën shkaku i pakënaqësisë për shiritin e kapitenit. "Unë mund vetëm të flas për atë se sa i rëndësishëm është ai (Xherdan) për këtë ekip. Ai është lojtar i madh, me cilësi të mëdha. Ai mund të na ndihmojë në çdo ndeshje dhe ne jemi shumë të mërzhitur që ai nuk është këtu me ne", ka thënë Xhaka. "Ne kemi edhe futbollistë të tjerë të cilët janë cilësorë, po ashtu. Nuk dua të flas për atë se çfarë ka ndodhur, sepse nuk i di arsyet e sakta, ama e di që për këto ndeshje e kemi humbur një lojtar të madh", ka shtuar Xhaka.

U tërhoq shorti për Superligën e futbollit

Në zyrën e Komisionit të Futbollit e në praninë e përfaqësuesve të klubeve është bërë tërheqja e shortit për edicionin e ri në Superligën e Kosovës në futboll. Garat do të nisnin më 20 shtator. Në javën e parë takohen: Drenica T-Prishtina01, Mabetex Prishtina-BB Llapi, Liburni-Peja, Malisheva-Juniku, Besa-Prizreni.

Dështon transferimi i Bekajt në Gjermani

Portieri i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Visar Bekaj, nuk do të transferohet në skuadrën gjermane Hoffenheim. Afati kalimtar i transferimeve në Gjermani ka përfunduar, ndërkohë që ka munguar kërkesa e klubit gjerman në sistemin TMS në drejtim të FC Prishtinës, raporton "Gazeta Sheshi". Lojtari ka kontratë ende me Prishtinën dhe ai nuk mund të transferohet më në asnjë skuadër si futbollist profesionist. Prandaj, e ardhmja e Bekajt pritet të jetë sërish në Prishtinë.

Hysaj: Mund ta mposhtim Francën

Kapiteni i Shqipërisë, Elseid Hysaj, dëshiron të besojë te shanset që ka ekipi i tij përballë Francës, të shtunën në mbrëmje, në ndeshjen kualifikuese të "Euro 2020". Kështu shkruan "France

Football", që i ka shkëputur 25-vjeçarit një koment të shkurtër për këtë takim të raundit të 5-të të sfidave në grupe. Hysaj nuk e përrjash-ton mundësinë që Shqipëria ta bëjë surprizën e madhe në

"Stade de France". "Ne duam rezultat pozitiv. Nuk vijmë këtu për të humbur. Franca është Francë, por jam i sigurt se me këtë grup dhe me këtë trajner (Edy Reja) ne do t'i tregojmë vlerat tona. Ne

shkojmë me idenë për të marrë pikë, një ose tre, me lojë të mirë dhe duke fituar terren. Sigurisht se do të përballlemi me një ekip më të fortë, por Shqipëria mund të fitojë", ka thënë Hysaj.



Superkupa organizohet në Rahovec

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) ka marrë vendim që Superkupa e Kosovës në të dyja konkurrencat të organizohet në palestrën "Mizahir Isma"

në Rahovec më 24 shtator. "Federata e Basketbollit të Kosovës në bashkëpunim me KB Rahoveci do t'i bëjnë të gjitha përgatitjet e duhura në mënyrë që këto ndeshje të organizohen në

atmosferë festive dhe që edicioni i ri në basketboll të fillojë në mënyrën më të mirë të mundshme", thuhet në njoftimin e FBK-së. Superkupa e Kosovës në konkurrencën e

meshkujve do të zhvillohet në mes të KB Sigal Prishtinës dhe KB Rahovecit, kurse ajo në konkurrencën e femrave ndërmjet KB Prishtinës dhe KB Bashkimit.



Vëllaznimi rrezikon shuarjen

GJAKOVË, 5 SHTATOR (ER) - Skuadra e Vëllaznimit nga Gjakova është duke kaluar nëpër një krizë të jashtëzakonshme. Futbollistët kuqezinj të mërkurës kanë bojkotuar stërvitjet dhe kanë paralajmëruar se nuk do të rikthehen derisa të shlyhet borxhi ndaj tyre. "Nuk mbahet në mend që Klubi i Futbollit Vëllaznimi të ketë qenë ndonjëherë në situatë më të vështirë sesa që është aktualisht. Me probleme të mëdha financiare dhe organizative, pa kryetar e pa kryesi, situata në klub është alarmante. Kryetari aktual Agim Cana, i cili për një vit e gjysmë ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm, ka paraqitur dorëheqje nga ky post, dorëheqje kjo që nuk është pranuar nga zyrtarët më të lartë komunalë. Pavarësisht prej kësaj, ai tash e një kohë është larguar nga Kosova. Ndërkohë fare nuk është sqaruar se kush do të marrë përsipër shlyerjen e borxheve të prapambetura por as kush do të marrë përsipër financimin e mëtejshëm të veprimtarisë së



klubit", thuhet në njoftimin e Vëllaznimit.

Sipas klubit gjakovar, bizneset nuk kanë dëshmuar gatishmëri të theksuar, ndoshta edhe nga pamundësia, që ta ndihmojnë ndjeshëm financiarisht klubin, ndërsa vetë Komuna e Gjakovës nuk po gjen formë që ta bëjë një gjë të tillë. Ndërsa ky klub me traditë të madhe në futbollin e Kosovës po rrezikon që të pushojë nga garat. "Futbollistët, atë që e kishin paralajmëruar disa herë kohë më parë, e jetësuan dje (e mërkurë). Të pakënaqur me mosshlyerjen e borxheve të prapambetura dhe mospagesën e pagave për këtë

edicion të garave, ata të mërkurës nuk pranuan të stërviten, duke paralajmëruar se nuk do t'u kthehen stërvitjeve derisa të mos përmbushën obligimet financiare ndaj tyre. Kjo ka bërë që situata në Klubin e Vëllaznimit të jetë vërtet alarmante dhe nëse brenda pak ditëve të ardhshme nuk gjendet ndonjë zgjidhje emergjente, klubi i formuar para 94 vjetësh dhe i regjistruar zyrtarisht para 92 vjetësh, rrezikon seriozisht të pushojë aktivitetin përkohësisht apo për një kohë më të gjatë", thuhet në njoftimin e lëshuar të enjten nga skuadra kuqezi e Gjakovës.

Vetteli: Pa ndihmën time Leclerc e Ferrari nuk do të fitonin në Belgjikë



BERLIN, 5 SHTATOR - Sebastian Vetteli pësoi në pistën e SPA një tjetër zhgënjim. Ai e nisi garën në pistën belge në vendin e dytë, por e përfundoi i katërti. "Me gomat që kisha e dija se nuk mund të ruaja atë pozicion. Ndaj, u përpoqa ta ulja ritmin e Mercedesit dhe ta ndihmoja Charlesin të shkëputej e

fitonte", u shpreh piloti gjerman i Ferrarit. Për Vettelin, suksesi i Leclerc në Belgjikë, fitorja e parë e "kokëkuqes" këtë sezon, ishte fitore e ekipi. "Ajo garë nuk ishte e mirë për mua, por për Ferrarin po. E pranoj që në këtë garë punova për skuadrën dhe mendoj se ia dola mbanë. Bëmë një hap përpara dhe kjo është

një notë pozitive për Ferrarin", ka deklaruar Vetteli. Edhe Leclerc i pranon se ndihma që i dha shoku i skuadrës ishte e rëndësishme në këtë sukses. "Pa ndihmën e tij dhe punën e madhe që bëri për t'i ngadalësuar dy makinat Mercedes nuk do ta kisha fituar garën", u shpreh piloti monogask.

SHKURT

Nadali kalon në gjysmëfinale, favorit në US Open

Rafa Nadali është favoriti kryesor për të triumfuar në US Open pas lamtumirave të Novak Djokoviçit dhe Roger Federerit. Tenisti spanjoll kishte paralajmëruar që nuk do ta kishte aspak të lehtë ndaj argentinasiit Diego Schwartzman (27 vjeç dhe numri 21 në renditjen ATP) dhe kishte të drejtë. Nadali triumfoi 3-0 me sete (6-4, 7-5 dhe 6-2) në 2 orë e 46 minuta lojë, por ishte i detyruar që ta kërkonte ndihmën e fizioterapistit. "Kalova disa çaste të vështira në fund të setit të dytë dhe në fillim të setit të tretë, por fizikisht jam mirë. I mbylla mirë dy ndeshjet e fundit. Ishte ditë e vështirë, sepse kishte shumë lagështi, por tani duhet të jem gati për gjysmëfinalen. Pikërisht në këtë raund Nadali do të përballet me italianin Matteo Berrettini, 23-vjeçar, i cili befasoi me rezultatin 3-2 francezin Gael Monfils (3-6, 6-3, 6-2, 3-6 e 7-6) në thuasje 4 orë lojë.

Hazardi rikthehet pas ndeshjeve të kombëtareve

Real Madridi nuk e ka nisur si duhet sezonin e ri në La Liga, duke lënë pikë që në ndeshjet e para. Trajneri Zinedine Zidane nuk ka pasur në dispozicion as blerjen më të shtrenjtë të verës Eden Hazard. Ky i fundit nuk u grumbullua as me Belgjikën për ndeshjet e radhës. Belgu ka vuajtur një dëmtim, ndërsa së fundmi ka lajme të mira për sulmuesin. 28-vjeçari ka nisur punën me topin dhe është shfaqur në fushën stërvitore të Real Madridit. Ai ndodhet nën kujdesin e rreptë të stafit mjekësor dhe atij teknik. Zidane shpreson ta ketë në dispozicion që pas ndeshjeve të kombëtareve. Hazardi ende nuk ka bërë debutimin në një ndeshje zyrtare me "Los Blancos", ndërkohë që u afrua mbipeshë në "Santiago Bernabeu".

Marchisio vazhdon karrierën në Francë

Claudio Marchisio u largua nga Juventusit para një viti teksa kaloi te skuadra ruse e Zenitit. Megjithatë, aventura e mesfushorit italian në Rusi zgjati vetëm një sezon, pasi më 1 qershor të këtij viti ai e prishi kontratën me Zenitin dhe ishte një lojtar i lirë. Nga sezoni i ardhshëm 33-vjeçari do të jetë një lojtar i Monacos në kampionatin francez. Sipas asaj që shkruan "Sportmediaset", lojtari ka arritur marrëveshjen me klubin nga Principata dhe sezonin e ri do të luajë në Ligë 1. Marchisio do të nënshkruajë një kontratë njëvjeçare me opsion rinovimi edhe për një vit tjetër.

Atletico synon transferimin e Eriksenit në janar

Atletico Madridi do ta tentojë transferimin e mesfushorit të Tottenhamit, Christian Eriksen, gjatë afatit kalimtar të janarit. Mësohet se Atletico tashmë po bën gati ofertën për danezin, i cili ka mbetur i zhgënjyer që nuk arriti të largohet nga Tottenhami gjatë afatit kalimtar të verës. Ai ka refuzuar rinovimin e kontratës me "Spurs" që i skadon në fund të këtij edicioni dhe gjasat janë të mëdha që të largohet në janar, pasi në verën tjetër do të jetë lojtar i lirë.

Lozano: Ronaldo më bëri komplimente

Hirving Lozano ishte pa dyshim një nga blerjet më të mëdha të kësaj vere në Serinë A dhe pa diskutim më e madhja për Napoli. Meksikani që në ndeshjen e parë i shënoi rivalit, Juventusit, duke treguar menjëherë potencialin e tij. Lozano në një intervistë për median e vendit të vet "TUDN", është shprehur për kalimin te Napoli dhe atë që i tha Ronaldo pas golit të shënuar. "Kur u shënuua goli i fundit, Ronaldo erdhi, u afrua dhe më bëri komplimente për ndeshjen që zhvillova. Më uroj mirëseardhje në Itali. Ishte diçka e këndshme sepse ai është një lojtar spektakolar, i një tjetër kategorie. E shijova atë ndeshje, sepse skuadra ishte fantastike, pavarësisht se luajtëm ndaj disa lojtarëve të mëdhenj", ka thënë Lozano.

Betohet Qeveria e re italiane

ROMË, 5 SHTATOR - Të enjten është betuar Qeveria e re italiane, e cila është krijuar pas koalicionit të Partisë Demokratike pro-Evropiane dhe Lëvizjes Pesë Yjet.

Administrata e re duket e sigurt se synon të ketë më pak konflikte me Bashkimin Evropian, për dallim nga qeveria e kaluar, e cila vazhdimisht ka kundërshtuar rregullat e bllokut evropian për buxhet dhe migrim.

Partia Demokratike do të udhëheqë Ministrinë e Ekonomisë dhe atë për Çështje Evropiane, derisa ish-kryeministri Paolo Gentiloni duket se do të bëhet komisionari i ri i Italisë në BE.

Kryeministri italian Giuseppe Conte, profesor pa lidhje politike, ka udhëhequr një ekip të ri prej shtatë grave dhe 14 burrave në ceremoninë e betimit në palatin presidencial.

Qeveria e 67-të e Italisë nga Lufta e Dytë Botërore u ka dhënë më shumë hapësirë politikanëve të rinj dhe jo aq shumë atyre me përvojë. "Do të jetë rrugëtim interesant", ka thënë ministri i Arsimit, Lorenzo Fioramonti.

Megjithatë kjo qeveri nuk do të ketë kompetenca të plota derisa të fitojë mocionet e votëbesimit në të dyja dhomat e Parlamentit javën e ardhshme.



Pasoja e një Brexiti pa marrëveshje

Një raport i ri paralajmëron se shkëputja e Britanisë së Madhe nga BE-ja pa një marrëveshje paraprake do të kishte pasoja ekonomike dhe politike për vite me radhë

LONDËR, 5 SHTATOR - Qeveria britanike njoftoi se do të shpenzojë 2.4 miliardë dollarë shtesë për ta planifikuar Brexitin, duke e çuar shumën totale të shpenzuar deri tani për shkëputjen e Britanisë nga BE-ja në mbi 10 miliardë dollarë. Një raport i ri paralajmëron se shkëputja e Britanisë nga BE-ja pa një marrëveshje paraprake do të kishte pasoja ekonomike e politike për vite me radhë. Shumë përkrahës të Brexitit e shohin tani daljen pa marrëveshje si rezultat të vetëm të pranueshëm, ndërkohë që debati po bëhet gjithnjë e më i polarizuar.

Dhjetëra-mija kamionë kalojnë nëpër Dover në një ditë të zakonshme. Kjo është pika kryesore lidhëse e Britanisë me kontinentin evropian. Kamionët bartin artikuj nga më të ndryshëm: pjesë makinash, ushqime të freskëta, gjedh e dhen si dhe ilaçe. Pjesa më e madhe e mallrave kalojnë pa u kontrolluar dhe pa tarifë. Por sipas një raporti të ri, shkëputja nga BE-ja pa marrëveshje do të sjellë tarifa dhe vonesa për gjysmën e eksporteve britanike. "Një tjetër ndryshim që do të sjellë shkëputja pa marrëveshje, përveç tarifave që janë në fakt relativisht të parëndësishme, është kontrolli doganor.

Kompanitë kanë temp shumë të ngjeshur, nuk magazinonë stoqe, nuk mund të lejojnë vonesa. Nëse fillon të ngadalësohet procesi do të vihet në pikëpyetje i gjithë modeli i tyre i biznesit", thotë analisti Anand Menon.

Këtu përfshihen kompani si Nissan, Honda dhe Ford, apo Airbus, i cili prodhon pjesë për avionë në Britani, ka njoftuar voa.

Raporti paralajmëron se rënia e vlerës së paundit ka gjasa të sjellë rritje çmimesh dhe ndoshta mungesa në ushqime të freskëta.

Qeveria britanike i ka hedhur poshtë këto parashikime dhe thotë se është e gatshme për shkëputje pa marrëveshje. Dje, qeveria njoftoi 2.4 miliardë dollarë shtesë për t'u përgatitur për Brexit. "Këto fonde do të mundësojnë shtimin e personelit doganor, zgjerimin e infrastrukturës në porte dhe mbështetje më të madhe për bizneset", tha sekretari i Thesarit Sajid Javid.

Sajid Javid thotë se Britania do të jetë në gjendje të sigurojë një pakt për tregti të lirë me Evropën, pas Brexit-it pa marrëveshje. Por analisti Menon thotë se s'është e lehtë. "Kur të realizohet shkëputja pa marrëveshje palët do të fillojnë të



shkëmbejnë akuza nga të dyja anët e Kanalit të Lamanshit sepse të dyja palët do të ndajnë pasoja ekonomike. Në një klimë të tillë politike do të jetë shumë e vështirë që të ulen në tryezë me dëshirë të mirë e të fillojnë negociatat", tha Menon.

Presidenti Donald Trump ka premtuar një marrëveshje tregtare me Britaninë pas daljes nga BE-ja, duke thënë se dy vendet mund të bëjnë 4-5 herë më shumë tregti. "Edhe nëse heqim çdo tarifë mbi tregtinë me Shtetet e Bashkuara, do të

fitonim 0.4 % të prodhimit të përgjithshëm bruto. Shkëputja pa marrëveshje do ta dëmtonte ekonominë për 10 vjetët e ardhshëm, më e pakta në masën 8-10 % të prodhimit të përgjithshëm bruto", thotë analisti Anand Menon.

Në Bruksel shkëputja pa marrëveshje tani shihet si skenar i mundshëm. BE-ja njoftoi të mërkurën se ka në plan t'i ndihmojë vendet anëtare duke lëvruar fonde të rezervuara për katastrofa natyrore. "Në mënyrë që të jemi plotësisht të

përgatitur për një Brexit pa marrëveshje, kemi bërë propozimet e duhura legislative. Më mirë të jemi të sigurt", tha Mina Andreeva, zëdhënëse e Komisionit Evropian.

Britania dhe BE-ja thonë se duan marrëveshje. Por nuk duket se një marrëveshje e tillë mund të arrihet brenda afatit të shkëputjes më 31 tetor.

Nëse nuk kapërcehet ngërçi në Parlamentin britanik, kanë mbetur vetëm pak javë para kaosit të një shkëputjeje pa marrëveshje.

Udhëheqësja e Hong Kongut tërhoqi projektligjin që nxiti protesta masive

HONG KONG, 5 SHTATOR - Udhëheqësja e Hong Kongut, Carrie Lam, tha se qeveria tërhoqi formalisht një projektligj mbi ekstradimin, i cili kishte nxiti protesta disamujshje.

Projektligji do të lejonte ekstradimin e banorëve të Hong Kongut në territorin e Kinës për t'u gjykuar. Ai nxiti protesta masive që u përshkuan me akte dhune dhe çuan në mbylljen e aeroportit me

herët gjatë këtij muaji.

Lam, e cila me tërheqjen e projektligjit përmbushi një nga kërkesat e protestuesve, tha në një paraqitje televizive se qeveria nuk do të pranojë kërkesat e tjera, përfshirë edhe atë për një hetim të pavarur të veprimeve të policisë kundër protestuesve. Sidoqoftë, ajo emëroi dy anëtarë të rinj në një agjenci mbikëqyrëse të policisë për të hetuar çështjen.

Protestuesit kanë kërkuar edhe lirin e personave të arrestuar por Lam tha se kjo është e papranueshme.

Një ligjëvënës tha se tërheqja e projektligjit është "veprim i paktë dhe shumë i vonuar".

Protestat në ish koloninë britanike filluan në muajin mars, por u rritën në qershor dhe që atëherë janë shndërruar në një lëvizje që kërkon më shumë demokraci.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva
Zdravstva-Ministry of Health



Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-Hospital and University
Clinical Service of Kosovo
Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, General Hospital
"Dr. Sami Haxhibeqiri"- Mitrovicë/a

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës /Nr. 03/L-212/ si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ /MPMS/ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik të MPMS, u.d. drejtori Ekzekutiv i Spitalit të Përgjithshëm "Dr. Sami Haxhibeqiri" – Mitrovicë, mori vendim dhe shpallë:

KONKURS PUBLIK

Institucioni: Spitali i Përgjithshëm "Dr. Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë
Titulli i vendit të punës: Mjek Specialist – Mjekësi Emergjente / dy (2) pozita/
Vendi i Punës: Spitali i Përgjithshëm "Dr. Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë
Kategoria funksionale/Grada: koeficienti i pagës / 8.40 /
Kontrata e punës: Në kohë të pacaktuar /sipas Ligjit të Punës/

Detyrat dhe përgjegjësitë: konform përshkrimit të vendit të punës të Spitalit të Përgjithshëm - Mitrovicë.

Shkollimi i kërkuar për pozitat mjek specialist: Të kenë arsimim universitar, specialist i lëmisë së kërkuar.

Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen për pozitat mjek specialist: Të kenë të mbaruar Fakultetin e Mjekësisë dhe specializimin adekuat të lëmisë përkatëse. Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë notën mesatare më të lartë gjatë studimeve themelore, njohjen e gjuhës angleze dhe që kanë trajnime të veçanta në fusha profesionale, si dhe njohuri të mira të funksionimit të sistemit shëndetësor të Kosovës;

Të kenë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë, të kenë njohuri të gjuhëve zyrtare në përdorim, njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme.

Dokumentet e kërkuara për pozitat mjek specialist: Diploma e Fakultetit, Çertifikata e specializimit, Licenca e Punës valide e Mjekut Specialist nga Institucioni kompetent i Republikës së Kosovës, kopje të letërnjoftimit si dhe çdo dokument apo çertifikatë trajnime që kandidati e vlerëson si përparësi në përgatitje të tij. Dokumentet e kërkuara të dorëzohen në kopje, origjinalin e këtyre dokumenteve ose të vertetuara në noteri do të kërkohej vetëm atëherë kur kandidati thirret për punë.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë veprimi, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësitë e kërkuara profesionale për kryerjen e detyrave.

"Spitali i Përgjithshëm – Mitrovicë ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë".

"Komunitetet jo shumicë dhe pjestarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional".

Procedurat e konkurimit: Konkurimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë rekrutimin: Procedurat e rekrutimit rregullohen sipas Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës / Nr. 03/L-212/ si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ /MPMS/ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik të MPMS.

Data e mbylljes së konkursit: 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen dhe kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e Arkivës në Spitalin e Përgjithshëm "Dr. Sami Haxhibeqiri" – Mitrovicë, Lagja Bair - 40.000, Mitrovicë. Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës.

Kontaktet me telefon mund të bëni në 028-530 -811.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva
Zdravstva-Ministry of Health



Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-Hospital and University
Clinical Service of Kosovo
Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, General Hospital "Dr. Sami
Haxhibeqiri" Mitrovicë

Na osnove clana 8. Zakona o radu Republike Kosova/br. 03/L-212/, Administrativnog Uputstvo /MRSZ/ br. 07/2017 za regulisanje Procedura Konkursa na Javnom Sektoru, izvršni direktor Opšte Bolnice "Dr. Sami Hadžibećiri" Mitrovica, doneo je odluku o raspisivanju:

JAVNOG KONKURSA

Institucija: Opšta Bolnica "Dr. Sami Hadžibećiri" Mitrovica
Naziv radnog mesta: Lekar specialista za Urgentnu Medicinu /dva (2) mesta/
Radno mesto: Opšta Bolnica "Dr. Sami Hadžibećiri" Mitrovica
Funksionalna kategorija/stepen: Koeficient LD /8.40/
Ugovor o radu: Na neodredjeno vreme/na osnovu Zakona o Radu/

Zadaci i odgovornosti: na osnovu zadatka na osnovu radnog mesta.

Potrebno školovanje za lekara specialista: Univerzitetska stručna sprema, specijalista odgovarajuće oblasti.

Sposobnosti/iskustvo i ostali atributi za lekare specialista: Kandidati treba da imaju završen medicinski fakultet, specijalizaciju odgovarajuće oblasti. Prednost će imati kandidati koji u toku studija imaju veću prosečnu ocenu, poznavanje engleskog jezika, koji imaju posebne stručne obuke, dobro poznavanje funkcionisanja Zdravstvenog Sistema Kosova. Da imaju dokazane sposobnosti za efektivnu komunikaciju na pismenom i govornom aspektu, da imaju znanja službenih jezika na upotrebi, znanje za upotrebu kompjutera je obavezna.

Potrebna dokumentacija za radno mesto lekara specialista: Diploma fakulteta, Uverenje o specijalizaciji, licenca rada lekara specialista od odgovorna institucija Republike Kosova, fotokopije

lične karte, kao i druga dokumentacija ili uverenja o stručnom usavršavanju koji kandidat smatra za prednost svoje stručne spreme. Tražena dokumentacija dostavlja se kopirana, originalna i overena dokumentacija kod notera tražiće se samo kada se vrši prijem kandidata u radni odnos.

"Opšta Bolnica – Mitrovica pruža jednake mogućnosti zaposljavanja svim državljanima Kosova i rado prima prijave za zaposljavanje od svi lica muskog i zenskog pola iz svih zajednica na Kosovu".

"Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju prava da budu proporcionalno predstavljeni na sektoru zaposljavanja"

Postupak konkurisanja: Konkurisanje je javno za sve zainteresovane kandidate.

Zakonski i podzakonski propisi koji uredjuju konkurisanje: Postupak rekrutacije propisano je Zakonom o Radu Republike Kosova, /br. 03L 2012./, Administrativnog Uputstvo /MRSZ/ br. 07/2017 za regulisanje Procedura Konkursa na Javnom Sektoru.

Datum zatvaranja konkursa: 15 dana od dana oglašavanja. Zahtevi dostavljeni nakon isteka roka neće se primiti kao i nekompletna dokumentacija neće se razmatrati. Zbog velikog broja dostavljenih zahteva, samo kandidati izabrani na listu užeg izbora će se kontaktirati.

Dostavljanje zahteva: Aplikacije uzimaju se i dostavljaju se u Kancelariji Pisarnice Opšte Bolnice "Dr. Sami Hadžibećiri" Mitrovica, Naselje "Bair" 40.000 Mitrovica.

Na aplikaciji treba jasno da se naznači naziv radnog mesta. Kandidati mogu da kontaktiraju na tel: 028/530/811.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. NR. 03/L-149 dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Drejtësisë shpallë këtë:

K O N K U R S

I. DIVIZIONI I PROKURIMIT

1. Pozita: Zyrtar i Prokurimit

Referenca: MD/DP/06 - 09 - 01- 2019

Koeficienti: 7

I përgjigjet: Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit

Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgatit materiale standarde, varësisht nga metoda e prokurimit;
- Përgatit dokumentacionin dhe ftesa për oferta për tenderë dhe dërgimin e tyre për shpallje në mjetet e informimit;
- Pranon fletëpagesa për material të tenderëve në listë dhe regjistrimi i të gjitha kompanive që marrin materialin e tenderit në listën e hartuar për këtë qëllim;
- Kontrollon faturat në pajtim me kushtet e kontratës, me shënimet mbi mallrat e pranuar te nënshkruara nga nëpunësi i emëruar për pranimin e mallrave, përgatit dokumentacionin për pagese dhe dërgon lendet për ekzekutim;
- Pranon oferta nga kompanitë në kohën e paraparë në tender, dokument dhe merr pjesë në përgatitjen e hapjes së ofertave;
- Merr pjesë në përgatitjen e procedurave të vlerësimit të ofertave;
- Mban të dhëna detale për të gjithë ofertuesit, për veprimet dhe vendimet e marra, si dhe nënshkrimi i komenteve nga secili anëtar;
- Kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkojnë kohë pas kohë nga mbikëqyrësi;

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe shkathtësitë tjera:

- Diplomë universitare: Fakulteti Ekonomik, Juridik ose Teknik;
- Së paku 2 (dy) vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën e prokurimit publik;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës koordinim eventual i personelit në nivel administrativ;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Marrja dhe dorëzimi i Aplikacioneve: Ministria e Drejtësisë / Divizioni për Burimeve Njerëzore, Rruga « Ish-Ndërtesa e Rilindjes» kati i 8 (tetë), Zyra Nr. 803, Prishtinë, Kosovë;

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni zyrën e Divizionit të Burimeve Njerëzore në, tel: 038 - 200 182 86, prej orës 08:00 - 16:00.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërin nga gazetat ditore, duke filluar nga data **06.09.2019** gjer më datën **20.09.2019**, që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda katër (4) ditësh, Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurroni.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Divizioni i Burimeve Njerëzore dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit intervistues.

“Shërbimi Civil i Kosovës u shërben të gjithë banorëve të Kosovës dhe mirëpret aplikimet nga femrat dhe meshkujt e të gjitha komuniteteve të Kosovës”.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

Na osnovu Zakona za Civilnu Sluzbu Republike Kosova L.BR. 03/L-149 i Uredbe Br. 02/2011 za Procedure Rekrutiranja u Civilnoj Sluzbi Republike Kosova, Ministarstvo Pravde (MP) objavljuje ovaj:

K O N K U R S

I. DIVIZIJA ZA NABAVKE

1. Pozicija: Službenik za nabavke - 1 (jedno) radno mesto

Referenca: MP/DN/06 - 09 - 01 - 2019

Koeficienti: 7

Odgovara: Rukovodioca Divizije za nabavke

Mesto: Pristina

Zadaci i odgovornosti:

- Priprema standardne materijale, u zavisnosti od načina nabavke;
- Priprema dokumentaciju i pozive za ponude za tendere i njihovo dostavljanje za objavljivanje u medijima;
- Prihvata uplatnice za tenderski materijal na listi i registracija svih kompanija koje prime tenderski materijal na spisku sastavljenom za tu svrhu;
- Proverava fakture u skladu s uslovima ugovora, uz beleške o primljenoj robi potpisane od imenovanog službenika za prijem robe, priprema dokumentaciju za plaćanje i šalje predmete na izvršenje;
- Prihvata ponude od kompanija u vremenu koje je predviđeno u tenderu, dokumentuje i učestvuje u pripremi otvaranja ponuda;
- Učestvuje u pripremi postupaka za ocenjivanje ponuda;
- Drži detaljne informacije o svim ponuđačima, za postupke i odluke, kao i potpisivanje komentara od svakog člana;
- Vršiti i druge zadatke u skladu sa svrhom radnog mesta koje nadzornik može povremeno zatražiti;

Uslovi, kvalifikacija, iskustvo, sposobnosti:

- Znanje i značajno iskustvo u oblasti tranzicione pravde i podrške žrtvama zločina;
- Visoke veštine upravljanja, organizacije, postavljanja ciljeva i planiranja;
- Dobro poznavanje efikasnog nadzora stručnog rada koje obavljaju potčinjeni;
- Komunikacijske i pregovaračke veštine na visokom nivou;
- Fleksibilan pristup prilikom organizovanja i nadgledanja posla, uključujući rešavanje problema;
- Kompjuterske veštine tokom primene programa (Word, Excel, Power Point, Access, internet);
- Univerzitetsku diplomu, Pravni fakultet, Filozofski fakultet ili fakultet za Javnu Administraciju, sedam godina profesionalnog radnog iskustva, uključujući najmanje 4 godine na poziciji rukovodilaca.

Prijem i predaja aplikacije: Ministarstvo Pravde/Divizija Ljudskih Resursa, Adresa Bivsa Zgrada „Rilindja“ Osmi (8) Sprat, Kancelarija Br. 803, Priština, Kosovo;

Za detaljnije informacije možete kontaktirati Kancelariju Divizije Ljudskih Resursa na Tel: 038 200 182 86, svakog radnog dana od 08:00 - 16:00 časova.

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u jednom od dnevnih novina, počevši od **06.09.2018** do **20.09.2019**, koji se smatra kao poslednji dan zaključenja Konkursa.

Aplikacije poslate poštom, koje sadrže poštanski žig o slanju poslednjeg dana odnosno roka za aplikaciju, smatraće se blagovremenim i uzet će se na razmatranje, aplikacije koje stignu van ovog roka i one koje su nekompletne neće se uzeti na razmatranje.

Uz aplikaciju bit će priložena kopija dokumenata o kvalifikaciji, radnom iskustvu, i druga potrebna dokumentacija koje zahteva radno mesto za koje se konkuriše.

Kandidati koji će biti izabrani za uži krug biće pozvani na intervju od strane osoblja pismeno ili putem telefona, i dužni su da sa sobom ponese originalne dokumente o kvalifikacijama i završnoj obuci, za verifikaciju od strane Personela.

„Civilna Služba Kosova služi svim stanovnicima Kosova, i pozdravlja Aplikacije žena i muškarca svih zajednica Kosovu“.



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, L. Nr. 03/L-149, Rregulloren Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS

Titulli i punës: Zyrtar për Biblioteka
Institucioni: Biblioteka e te vërbërve "Syri Ync"
Divizioni: I Librit dhe Botimeve
Kategoria funksionale: Koficijenti : 7
Numri i referencës: 61/2019
I përgjigjet: Udhëheqësit të Divizionit të Librit dhe Botimeve
Vendi: Prishtinë
Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Divizionit të Librit dhe Botimeve kryen detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

- Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me menaxherin dhe stafin tjetër profesional për zbatimin e shërbimeve dhe produkteve përkatëse;
- Kryen detyra të specializuara, sipas kërkesës, në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
- Kryen detyrat në fushën profesionale specifike me një shkallë të arsyeshme të pavarësisë, me mbikëqyrje dhe udhëzime të kohëpaskohshme;
- Bën hulumtime dhe analiza sipas kërkesës dhe kontribuon në hartimin e rekomandimeve për shqyrtim nga nivelet më të larta;
- Merr pjesë në grupe punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë.
- Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij për shkëmbim të informatave dhe zhvillimin e punës në fushat e interesit të përbashkët;
- Raporton rregullisht të mbikëqyrësi rreth progresit në lidhje me planet e punës të miratuara;
- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

- Diploma universitare, në shkencat shoqërore, mardhenie nderkombetare, fakulteti juridik, ekonomik, gjuhë dhe leteri, fakulteti i edukimit minimum 2 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri të thellë në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathësi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventuale i personelit në nivel administrativ;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Procedurat e konkurrimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët.

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është me afat të pacaktuar.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.

Data e fundit e aplikimit është: 20.09.2019

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Tereze" Nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211449 dhe 038 211921 (apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>). „Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-149 mbi Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës“. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Na osnovu Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosova, Z. br.03/L-149 i Uredbe br.02/2010, o Procedurama Rekrutiranja u Civilnoj Službi Republike Kosova, Ministarstvo kulture, omladine i sporta objavljuje:

KONKURS

Naziv radnog mesta: Službenik za Biblioteke
Institucija: Biblioteka za slepa lica "Syri Ync"
Divizija: Knjige i Izdanja
Funkcionalna kategorija: Koeficijent : 7
Referentni broj: 61/2019
Odgovara: Rukovodiocu Divizije za Knjige i Izdanja
Mesto: Priština
Dužnosti i odgovornosti: Pod nadzorom Rukovodioca Knjige i Izdanja, obavlja dolo navedene dužnosti i odgovornosti:

- Razvija i odobrava planove rada i rokove sa menadžerom i drugim stručnim osobljem za sprovođenje relevantnih usluga i proizvoda;
- Obavlja specijalizovane zadatke, prema zahtevima, iz specifične profesionalne oblasti u skladu sa važećim zakonima, uredbama, politikama i procedurama, unutar određenih vremenskih rokova;
- Obavlja zadatke iz specifične, profesionalne oblasti, sa jednim razloznom stepenom samostalnosti, s povremenim nadzorom i uputstvima;
- Vrši istraživanja i analize prema zahtevu i doprinosi u uređenju preporuka za razmatranje od najviših nivoa;
- Učestvuje u radnim grupama iz specifične profesionalne oblasti, kada se tako nešto zahteva.
- Komunicira unutar i van institucije o razmeni informacija i razvoja delatnosti iz oblasti zajedničkog interesa;
- Redovno izveštava kod nadzornika oko progressa, u vezi prihvaćenih planova rada;
- Izvršava i svaki drugi zadatak iz specifične i profesionalne delatnosti, koja mogu da se zahtevaju na razlozan način, s vremena na vreme.

Zahtevano obrazovanje, iskustvo, sposobnosti i lične karakteristike:

- Univerzitetska diploma iz društvenih nauka, međunarodnih odnosa, pravnog fakulteta, ekonomije, jezika i književnosti, obrazovnog fakulteta sa najmanje 2 godine profesionalnog iskustva;
- Duboko i specijalizovano znanje iz specifične stručne oblasti stečeno univerzitetskim obrazovanjem i odgovarajućih obuka;
- Poznavanje važećih zakona i uredba;
- Komunikacijske veštine i planiranje rada, eventualne koordinacije osoblja na administrativnom nivou;
- Istraživačke, analitičke i ocenjivačke veštine i formuliranje preporuka i stručnih saveta;
- Veštine iz kompjuterski softverski programa (Word, Excel, Power Point, Access);

Procedura konkurisanja: Konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate.

Trajanje imenovanja: Imenovanje je na neodređeni rok.

Datum zatvaranja konkursa: Konkurs je otvoren 15 (petnaest) dana.

Zadnji datum za apliciranje je: 20.09.2019

Aplikacije koje se šalju putem pošte, sa poštanskim markicama, na poslednji datum konkursa, smatraju se važećim.

Podnošenja zahteva: Aplikacija se uzima i predaje u kancelariji broj 27 u Ministarstvu Kulture, Omladine i Sporta, Trg "Majka Tereza", Br. 44. Za dodatne informacije, kontaktirajte broj 038211449 i 038 211921 (ili na veb-stranici <http://www.mkrs-ks.org/>). Civilna Služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja aplikacije od svih osoba muškog i ženskog i od svih zajednica na Kosovu. Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravičnu i proporcionalnu zastupljenost u organima civilne službe unutar javne, centralne i lokalne administracije, kao što je navedeno u Članu 11. Stav 3, Zakona br. 03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova. Aplikacije poslate nakon zadnjeg datuma kao i ne kompletirani aplikacije, neće se primiti. Zbog velikog broja primljenih aplikacija, kontaktiraće se samo kandidati koji su odabrani u užoj listi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministri of Education, Science and Technology

Anulim i konkursit

Anulohet konkursi për pedagogë dhe psikologë i shpallur më datën 26 qershor 2019.

Poništavanje konkursa

Poništava se konkurs za pedagoge i psihologe objavljen dana 26 jun 2019.



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice



Njoftim për zgjatje të afatit të konkursit

Afati i aplikim për konkursin e shpallur në Akademinë e Drejtësisë me datën 21 gusht 2019 për pozitën: Zyrtar për zhvillim dhe bashkëpunim Gjyqësor, me numër të referencës 02/09/DP-AD, shtyhet edhe për shtatë (7) ditë kalendarike, për shkak se nuk është arritur numri i balancuar i aplikacioneve nga aspekti etnik dhe gjinor. Data e fundit për aplikim është 12 shtator 2019. Andaj për informata shtesë mund t'i referoheni konkursit të shpallur për këtë pozitë në gazetata ditore, faqen e internetit të Akademisë së Drejtësisë.

Numrat kontaktues: Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në këtë numër telefoni: 038 200 18 661, 038 200 18 671 prej orës 08:00-16:00, ose në emailin:

burimenjerczorc.ad@rks-gov.net.

Obaveštenje o produženju roka prijavlivanja

Rok za prijavlivanje na konkurs objavljenog u Akademiji Pravde 21. avgusta 2019. godine, za poziciju: Službenik za razvoj i pravosudnu saradnju, sa referentnim brojem 02/09/ DP-AD, se produžava za sedam (7) kalendarskih dana, pošto postignut uravnotežen broj prijava sa etničkog i polnog aspekta. Krajnji rok za podnošenje prijava je 12 septembra 2019. godine. Dakle, za dodatne informacije možete se obratiti objavljenom konkursu za ovu poziciju u dnevним novinama i na veb stranici Akademije Pravde.

Kontaktni brojevi telefona: Za dodatne informacije možete nas kontaktirati na sledeće brojeve telefona: 038 200 18 661, 038 200 18 671 od 08: 00-16:00 sati, ili preko imejla:

burimenjerczorc.ad@rks-gov.net

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Banesë me qira në Dardani për çif bashkëshortësh. Banesa ka 50 m2 me një dhomë gjumi, sallon e kuzhinë, banjo e ballkon dhe shpajz. Kati i 7 me lift. Çmimi 250 Euro kontakti 044-171328.

► Bashkim Shala shpall të pavlefshme Diplomën e Shkollës mesme Teknike "Anton Çetta" Skenderaj.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/giejpuneshpejte



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

